

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të marrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë 26 maj 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 14 prill 2022;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 prill 2022;
3. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve;
4. Shqyrtimi i raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për aprovimin e listës së veçantë që planifikohet për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2022;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Peticionit i përthashkët i banorëve të sheshit "Adem Jashari" dhe rrugës "Galip Badivuku" për largimin e trafos së rrymës nga sheshi.
9. Të ndryshme.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PËR/ZA/TO:	Kuvendin e komunës
NGA/OD/FROM:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunes së Vushtrrisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Sekretarisë së kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 12.5.2022

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 1, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 12 maj 2022 ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i listës së të propozuarve për mirënjohje.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të hartohet si propozim – vendim dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluasjtshme të komunës.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të përmirësohet preambula dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për emërimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Peticionit i përbashkët i banorëve të sheshit "Adem Jashari" dhe rrugës "Galip Badivuku" për largimin e trafikut së rrymës nga sheshi.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kërkesën e komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, por Drejtoria për Urbanizëm ta përgatis një rekomandim për këtë çështje.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 14 PRILL 2022

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, , Gresa Muli Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nuri Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Mehollu, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Gentiana Rama, Shkelzen Xhaferi, Nasuf Aliu dhe Mek Selaci.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Pas shqyrtimit të rendit të ditës , kuvendit pas votimit me 24 vota “për” 4 vota “kundër” aprovoj këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartje të të hyrave vetanake buxhetore nga viti 2021 në vitin 2022;
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësim të vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Tregut të Gjellbër për prodhime vendore në Vushtri.

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartje të të hyrave vetanake buxhetore nga viti 2021 në vitin 2022;

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- tha se meqë jemi në seancë të jashtëzakonshme vazhdojmë me votimin për rend dite, duke shtuar se hapim rendin e ditës me pikën e rendit të ditës për bartje të të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se lidhur me propozimin për bartje të mjeteve vetanake, kërkoi të sqarohet çështja e hartuesit, meqë hartues paraqitet të jetë Abit Abiti- zyrtar kryesor financiar, kurse nënshkrues dhe raportues drejtori i buxhetit, pasi kjo nuk është në harmoni me Ligjin për procedura administrative. Pastaj tha se drejtorët janë staf politikë dhe në bazë të statutit i kanë gjithë kompetencat, por jo zyrtarët ose ZKF nuk mund të adresojnë shkresa në kuvend, dhe për këtë kërkoi mendim edhe nga zyra ligjore. Tutje tha se vitin e kaluar kemi marrë vendim për subvencionimin e klubeve futbollistike, shoqatave dhe OJQ-ve, vlera e tyre është 200.000 euro, i njëjti ka mundur të aprovohet vitin e kaluar dhe mjetet mos të shkojnë në suficit dhe mos të barten obligimet, mirëpo mungesa e llogaridhënies dhe përgjegjësive kanë ndikuar që buxheti të ketë suficit vitin e kaluar, si dhe mosaprovimi i vendimeve të kuvendit. Pastaj tha se Drejtorja e Buxhetit nuk e ka kryer obligimin e vet që ka pas dhe e ka dëmtuar buxhetin në ç'rast po na barten obligimet, kështu që kërkoi të merren masa për secilin në mënyrë individuale për moskryerjen e punëve konform përgjegjësive që i ka. Mandej tha se në këtë legjislaturë janë anuluar shumë vendime, e të cilat i konsideron se janë anuluar pa bazë, dhe ekziston rreziku për të gjithë ata që kanë pas marrëdhënie kontraktuale me komunën ose kanë qenë para kualifikimit do të shkojnë tek përmbaruesi, kështu që i kërkoi të gjitha vendimet e anuluar që t'i sjellen në kopje fizike dhe se ku ka qenë qëllimi i anulimit dhe rrezikimit të buxhetit në këtë formë, duke shtuar se nëse rrezikohet buxheti, përgjegjësia do të jetë individuale. Ai propozoi që për vlerën 200.000 euro të dakordohemi dhe të kryhet pagesa për projektet që janë të cekura në këtë propozim-vendim. Qëllimi i çdo buxheti në çdo qeveri është zhvillimor, edhe pse qeveria ka bërë një punë dyditore dhe këtu ai tha se nuk shoh ndonjë projekt të zhvillimit të qytetit dhe ekonomisë lokale, e që është dashur një konsultim me deputetët. Ai kërkoi që të shtyhet votimi dhe të rishikohen nevojat dhe interesat e qytetarëve dhe jo të drejtorive sepse nuk mund të arrijnë asgjë me këtë shpërndarje.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – kërkoi të respektohet Rregullorja e kuvendit për shkak të minutazhës.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – tha se kjo pikë e rendit të ditës po sjellët me urgjencë, e cila ka mundur të sjellët në mbledhjen e rregullt të muajit mars, kur keni pasur mjaft kohë për t'u përgatitur dhe tani po e sillni në mbledhje të jashtëzakonshme të papërgatitur mirë. Tutje tha se në një pikë janë të përmbledhura dy vendime e që është dashur të jenë dy pika të rendit të ditës, dhe në forma të ndara. Së pari duhet të jetë vendim për shpërndarjen e hyrave të tejkaluara për vitin 2021 dhe vendim për bartjen e të hyrave të pashpenzuara për vitin 2021 dhe të hyrave të tejkaluara të vitit 2021. Andaj nëse nuk i ndjekim këto procedura edhe ky vendim do të kthehet prapa në kuvend, sikurse vendimet tjera për buxhetin. Tutje shtoi se para se të sillen në kuvend duhet të konsultoheni me zyrtarë profesionistë të drejtorive e jo të sillen vendime të marra në ekskursione. Pastaj shtoi se preambula e vendimeve është e thirrur gabim, thirret në Ligjin për buxhet 07/L-001 2020, e që duhet të jetë Ligji i buxhetit 07/L-041 2021, andaj kthimi i këtyre vendimeve për disa herë në kuvend do të ndikojë në performancën e kuvendit dhe do të ndikojë në grantin e performancës e që komuna jonë ka qenë në krye të komunave për këtë grant. Në fundi ai kërkoi që të shtyhen këto pika të rendit të ditës për seancën e rregullt meqë është material i papërgatitur, si dhe pyeti se sa i ka kushtuar buxhetit të komunës kjo vizitë e zyrtarëve në Shqipëri.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - tha se vizitat në Shqipëri kanë kushtuar 675 euro për 27 persona, dhe e gjithë puna ime do të organizohet në grupe, në ç'rast nuk ka mundësi të punohet në rregullore dhe dokumente tjera nëpër zyra. Tutje tha se si ekzekutiv kemi të drejtë t'i sjellim propozimet në kuvend dhe ju vendosni për votim, kurse sa i përket nënshkrimit të materialeve tha se zyrtarët janë në dijeni se ku e vendosin nënshkrimin, përndryshe secili do të ndëshkohet për mospërgjegjësi. Për dy pikat e rendit të ditës tha se i kemi sjellë në kuvend në mënyrë që të debatojmë sepse janë projekte nga mjetet e bartura dhe ju jeni ata që vendosni për votim.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit - tha se unë e ceka gabimin tek preambula dhe forma e sjelljes është gabim, sepse duhej të vinin dy vendime të ndara dhe jo kështu pa renditje dhe gjithashtu të sjellën në seancë të rregullt.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – tha se në lidhje me seancën e jashtëzakonshme kërkoi nga qeveria të jenë më kompetitiv, në mënyrë që pikat që janë të planifikuara për seanca të rregullta të mbahen dhe të përfundojnë në seancë të rregullt. Në lidhje me materialin dhe pikat për bartje të të hyrave dhe shpërndarjen e tyre, tashmë në disa seanca nuk po na vijjnë të përgatitura në konditat ligjore dhe kjo sikur po bëhet rutinë, në ç'rast pyeti se kjo mospërgatitje e duhur e materialeve a është nënçmim ndaj kuvendarëve apo paaftësi e tyre që i përgatitin. Tutje ai iu referua dhe fjalimit të z.Azemit i cili tha se këto projekte nuk janë zhvillimore për qytetin, por dilemat ishin se kujt t'i besohet, qeverisë apo përfaqësuesit kuvendar të PDK-së dhe kërkoi të sjellin argumente për ato projekte që nuk janë zhvillimore, si të bëhen zhvillimore.

Galip Avdiu, anëtar i kuvendit – tha se kam një kërkesë, ka një numër të madh të studentëve vushtrrias që studiojnë jashtë vendit, dhe nga mjetet e bartura të ndahet një shumë për këta studentë, të ndahen 10.000 euro nga ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Pasomë, meqenëse nuk është bërë ende studimi i fizibilitetit. Kjo shumë do të ishte një ndihmë e kënaqshme dhe përkrahje për vendin.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës - sa i përket sqarimit që e kërkoi z.Ilmiu tek rasti i subvencioneve, që është vendimi me 200.000 euro me vitin e kaluar, ndërsa sa i përket planifikimit të buxhetit kanë qenë 130.000 euro te subvencionet tek Drejtoria e Kulturës, kurse me të hyra të bartura janë planifikuar me 30 plus, që i bie 160.000 euro, dhe pjesa tjetër do të mbulohet nga subvencionet tek Zyra e kryetarit ose me rishikim të buxhetit, kështu që ajo shumë do të mbulohet tërësisht prej ati vendimi, ose do të harmonizohet bashkërisht në njërin nga seancat e kuvendit ky vendim.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se bëhet fjalë për vlerën për investime kapitale për 260.000 euro, është gabim tek fshati Pasomë, meqë nuk ka qenë fjala për ndërtimin e rezervuarit të ujit, por për kodrat e fshatit Skoqne dhe bashkë me kompaninë e ujësjellësit në shumë takime që kemi mbajtur, prioritet e kemi sigurimin e ujit të pijes për qytetarë dhe kemi planifikuar të bëjmë një rezervuar për shkak se fshatrat e pjesës lindore, si: Pasoma, Tërllobuqi, Dumnica, Sfarçaku i Epërm, Studime e Epërme, një pjesë e Samadrexhës, Cecelisë, Sllakocit dhe Stanocit të Epërm do të kenë probleme, por arsyeja pse mjetet kemi dashur t'i shpërndajmë nëpër projektet tjera është se fillimisht e kemi iniciuar studimin e fizibilitetit, meqë shtrirja e rrjetit të ujësjellësit nga fabrika është bërë pa studimin e fizibilitetit dhe tani po kemi pasoja në terren. Tutje tha se do ta bëjmë studimin e fizibilitetit në mënyrë të detajuar dhe këtë vit është e pamundur edhe të bëhet studimi i fizibilitetit, të hartohet projekti dhe të fillojë zbatimi i tij, prandaj tha se e sheh si të arsyeshme që në kodrat e fshatit Skoqne të ndërtohet rezervuari, të mbushet me pompa, dhe kështu eliminohen shumë sisteme të pompimit që janë paraparë. Kjo është arsyeja e ridestinit të 60.000 eurove, kurse 55.000 euro kemi menduar t'i dërgojmë në subvencione, si dhe ndërtimin e një shkollë në fshatin Gllavatin, sepse është shkollë në gjendje të keqe. Aty ka mjaft nxënës meqë është mbyll

shkolla tek Berishtë, dhe pasi edhe në fshatin Stroc ekziston shkolla e mesme e ulët, do të bëjmë një ndarje nga shkolla e mesme e ulët dhe shkolla fillore. Tutje tha se 90.000 euro kemi menduar për investime në QMF në dalje të Vushtrrisë, për zyra administrative dhe një rregullim dhe shumë e bursave për studentë në vlerë në 10.000, dhe kjo është shuma prej 260.000 euro që e kemi planifikuar për ndarje, këto janë vetëm propozime dhe bashkërisht do vendosim.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- tha se projektet nuk janë që sjellin zhvillim, me përjashtim të ndërtimit të një shkolle, buxheti në tërësi është shpenzues. Ai prapë ceku gabimet teknike dhe preambulën e vendimeve dhe kërkoi që këto vendime të sjellen për seancën tjetër. Sa i përket vizitës në Shqipëri ai tha se sipas informatës janë shpenzuar 3000 euro dhe ju e keni cekur një shumë më të vogël dhe po ashtu kërkoi raport për këtë çështje.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se çdo shpenzim do të dalë në pasqyrë të raportit, duke bërë një krahasim dhe duke cekur shpenzimet e karburanteve të ish- qeverisë për një afat tremujor nga 8651 km në 3700.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit – tha se në plan e pash ndërtimin e rezervuarve, sipas asaj së pari bëhet studimi i fizibilitetit dhe disa vite procedurat e ndërtimit, dhe ne e dimë se në shumicën e pjesëve janë vendos orët edhe kyçja individuale. Në luginën e “Lumit të Kuq”, mjafton një pompë, shembull në Pestovë vendoset një pompë dhe kjo i furnizon gjitha ato pjesë në luginë, e cila e kryen funksionin dhe nuk kemi arsye të presim 4 vite.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës- tha se ne do të fillojmë tani me sistemin e pompimit derisa të përfundojë projekti në fjalë.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit – pyeti kryetarin se jeni zotuar se klubi i futbollit do të subvencionohet me 100.000 euro dhe tha se, sa e pash në Drejtorinë për Kulturë dhe Sport, janë vetëm 140.000 dhe sa mjafton kjo shumë për klubet tjera, organizatat tjera rinore, kulturore, përderisa jeni zotuar se do të subvenciononi klubin e futbollit me 100.000 euro dhe pse nuk keni nda më shumë mjete për këto kategori. Lidhur me ndërtimin e sallës në objektin e komunës, ajo pyeti se për çfarë shërben kjo sallë.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - tha se për subvencionet e kategorive sportive dhe rinore do të vendosim bashkërisht, kurse sa i përket sallave ai tha se janë të domosdoshme meqë ka drejtori që janë mbingarkuar nga dokumentacioni dhe duhet krijuar kushte më të mira për zyrtarë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit - tha se ju jeni zotuar që do ta subvenciononi klubin e futbollit me 100.000 euro, kurse tani nuk dihet a do t’i kemi 100.000 për të gjitha klubet, duke e shprehur mirëkuptimin për përkrahje, por duke iu përmbajtur zotimit të dhënë nga ana e kryetarit. Tutje tha se tek kategoria 3 subvencione dhe transfere, kodi 73033, administrata, shuma 110.000, sa ka njohuri tha se kjo drejtori nuk ka pas subvencione në të kaluarën dhe ai kërkoi sqarime për destinimin e këtyre mjeteve. Kurse sa i përket sallës kërkoi për sallën e kuvendit t’i rregullohet zërimi, ulëset dhe tavolinat meqë nuk mjaftojnë as për shpalosjen e materialit, si dhe votimin elektronik.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës - tha se ne po mundohemi që në bashkëpunim me kryesinë të jemi në superligë në 100 vjetorin e themelimit të klubit dhe kërkesë e tyre ka qenë ndarja e mjeteve, ndërsa në bisedë e sipër me klubin kemi bë një planifikim dhe kemi nxjerr shpenzimet dhe kështu jemi munduar që për këtë vit t’i mbulojmë shpenzimet e lojtarëve dhe po ashtu kemi arrit dakordancë me një pjesë të kompanive për ta subvencionuar klubin dhe ajo po vazhdon, meqë buxheti nuk është lejuar ende dhe pagesat nga komuna për lojtarë nuk janë kryer dhe i siguroi që këto mjete për klubin do të ndahen. Sa i përket sallës së kuvendit tha se është e planifikuar me buxhet votimi elektronik dhe zërimi, kurse sa i përket tavolinave është e pamundur

për shkak të limiteve buxhetore për këtë vit, ndërkaq pyetjen për administratë në shumën 110.000 euro fjalën ia kaloi Abit Abitit.

Abit Abiti, ZKF – tha se i kemi përgatit materialet me ndryshime, kurse për shumën e cekur në administratë tha se kemi planifikuar shpenzimet e varrimit, dhe me ndryshime i kemi paraparë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ku sqaroi se nuk janë në administratë komunale, por janë në administratë të shëndetësisë, dhe në konsultim me menaxherët jemi dakorduar t'ia bartim DSHP-së.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- tha se po shihet se qeveria nuk i ka të qarta vijat buxhetore, të cilat vet i ka prezantuar, duke i kritikuar për materialet me ndryshime dhe kërkoi që kjo pikë të shtyhet dhe të analizohet në mënyrën meritore dhe shumë e kompletuar kish me dal kur të punohet bashkërisht dhe të caktohen prioritetet meqë nuk është pikë urgjente.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit- tha se nuk janë në rregull materialet e ardhura sepse diçka tjetër kemi para vetes dhe diçka tjetër votojmë, duke shtuar se nuk guxojnë të ndryshojnë kodet buxhetore pas votimit në kuvend. Tutje porositi kryetarin ta gjejë problemin e hallkës së buxhetit lidhur me planifikimet, meqë siç e ceku ai nuk qëndron problemi tek zyrtari financiar ku kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit - kërkoi të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – tha se kur është propozuar buxheti në muajin janar, kishte propozuar që të ndahen 40.000. euro për meremetimin e ish-objektit të shkollës “Migjeni”, e cila i është dhënë një kompanie dhe ka qenë zotim i kryetarit të komunës për ndarjen e këtyre mjeteve nga mjetet vetanake të komunës dhe tani po e shoh se po mungon në tabela dhe kërkoi të futet në tabelat e cekura. Tutje kërkoi sqarim nga zyra ligjore se a duhet të jenë të ndara vendimet dhe sipas opinionit të zyrës ligjore t'na vijë të përgatitura në mbledhjen e ardhshme.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit – tha se këtu i kemi dy pika të rendit të ditës dhe ju i keni futur në një pikë, e në realitet duhej të ishin tri pika të rendit të ditës. Tek bartja e mjeteve të të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 tha se materialin e kem para vetes dhe janë të specifikuar në kategori dhe kushdo që ka vërejtje, sugjerime mund të japin këshilla dhe kjo mund të bëhet e plotfuqishme dhe nuk lë arsye për shtyrje në seancën tjetër.

Melihate Basholli – Latifi - tha se kjo pikë e rendit të ditës do të shtyhet për një seancë tjetër, meqë 18 vota janë “për”, një “kundër”, tjerat abstenim.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësim të vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri;

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se në seancat tjera kemi marrë vendim për caktim të lokacionit të taksitë, por e kemi sjellë një alternativë tjetër për tek shtëpia e Mahmut agë Gjinollit, mosvendosjen e lokacionit që në fillim tek shtëpia e Mahmut agë Gjinollit e arsyei sepse 6 ari tokë në atë pjesë duhet të bëhet shpronësimi nga KEK-u.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- tha se edhe ky propozim është proceduar në formë joligjore për arsye se nuk mund të bëhet plotësim–ndryshimi me prona tjera, nëse vendimi ka lëshime që është votuar në kuvend për pronat e votuara, mund plotësohet dhe të votohet prapë, kurse ky është dashtë të vijë si propozim –vendim i ri ose anulim i propozim-vendimit paraprak. Tutje tha se kemi të bëjmë me pronë private të KEDS-it, që në këtë rast mund ta votojmë nëse është në

marrëveshje kontraktuale me KEDS –in për marrje me qira, ndërsa nëse mendohet të bëhet me shpronësim janë procedura tjera.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit - tha se edhe kjo pikë është sjell gabim në kuvend pasi nuk është i qartë vendimi se çka kërkohet, duke shtuar se nëse propozohen lokacionet që janë në këtë vendim, ose parcela në fjalë, atëherë duhet të vjen si propozim i ri për caktim të lokacionit dhe është parcelë e vogël dhe gjysma nuk i takon komunës.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit - tha se për ndryshim të lokacionit nga vendimi paraprak tha se kjo është mbivendosje dhe nuk mund të mbivendoset, kur janë dy pozicione të ndryshme territoriale gjeografike në qytet. Tutje nuk është pozicioni i duhur pasi aty është investuar, është ndërtuar një park, një shëtitore, dhe të shkatërrohet ky investim dhe të shndërrohet në diçka tjetër kjo është e papranueshme dhe qasje jo zhvillimore. Andaj propozoi që kjo pikë të shtyhet për ndonjërin nga seancat e radhës që kjo temë të analizohet mirë duke gjetur edhe ndonjë lokacion tjetër më të përshtatshme dhe që i plotëson kushte për një destinim të tillë. Duhet pasur ndonjë ide më kreative dhe për të cilën do ta kenë përkrahje edhe të grupit të tyre kuvendar, dhe vlerësoi se nuk është në rregull caktimi i lokacionit tek vendi i quajtur “Shtëpi e Mahmut Agë Gjinollit” duke u shkëputur parku, hapësira gjelbërues dhe hapësira rekreative që janë ndërtuar aty.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës –sqaroi se lokacioni i propozuar për treg tek ish-Ambulanca e vjetër, ka qenë vetëm një opsion shtesë që është menduar një sipërfaqe prej 18 ari që do shërbente si treg për prodhues vendor, por nëse vlerësoi si i papërshtatshëm atëherë letë shkohet me lokacioni i cili veç është caktuar më herët. Është menduar si opsion i mirë dhe ideja ka qenë që sipërfaqja prej 6 ari ti merret KEDS-it, duke shpallur si zonë me interes për komunën dhe që më vonë të bëhet shpronësimi i asaj parcele nga komuna për që fillimit nevojite vendimi i kuvendit të komunës. Në fund të diskutimit kryetari i komunës i ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit që jeni pjesë e një iftari i përbashkët në hotel-restorant Amazona për nderë të muajit të shenjët të Ramazanit.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, ishte konkluzion i përgjithshëm që derivoj nga diskutimet e anëtarëve të kuvendit që kjo pikë e rendit të ditës të mos aprovohet.

Mbledhja përfundoj në ora: 11:35.

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E III E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 PRILL 2022

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-deklaroi se është i detyruar të ngritë një çështje që si siç e ka cilësuar deputetja Melihatet Basholli e natyrës sensitive, e për të cilën ka menduar se sot ajo nuk do të jetë e ulur në karrigen e kryesueses së kuvendit pasi që ajo është dashur të jap dorëheqje të parevokueshme. Pasi që kjo e fundit ka krijuar një skandal të madh duke keqpërdorur pozitën zyrtare, duke tejkaluar kompetencat dhe obligimet ligjore dhe përsërit se po ishte në vendin e saj do të jepte dorëheqje të parevokueshme nga pozita e kryesuese pasi që dorëheqja duhet kuptuar si akt moral për skandale për gabime për mos përmbushje të objektivave për mos aftësi e shumë arsye tjera. Tutje shtoi se deputetja Basholli-Latifi duke keqpërdor detyrën zyrtare dhe pa dijeni, pa autorizim dhe pa vendim të kuvendit të komunës, ka dërguar shkresa zyrtare në emër të kuvendit të komunës dhe duke u thirrur në emër të 35 anëtarëve të kuvendit, iu është drejtuar organeve gjegjëse si Agjencisë Kundërkorrupsionit, ku ka kërkuar opinion ligjo lidhur me pronat komunale të dhëna në shfrytëzim afatgjatë në Parkun Industrial në Lumadh. Shkresa të tilla ka dërguar edhe nëpër ministri, krime ekonomike etj. Mandej e njëjta kishte pranuar një opinion ligjor nga Agjencioni Kundërkorrupsion dhe të njëjtin e ka mbajtur të fshehur nga anëtarët e kuvendit të cilin opinion siç edhe e din asnjëri nga deputetët zyrtarisht nuk e kemi pranuar. Për këtë opinion ai është

njoftuar nga media portalet elektronike, në këtë rast edhe kryetari dhe nënkryetari i komunës kanë pasur bashkëpunim-bashkëkryerje, të njëjtin opinion të cilën është dashur tu dërgojnë deputetëve ia kanë plasuar portalit veriu.info që pronarin e këtij medium e kanë mik. Pasi ai ka kuptuar për ekzistencën e këtij opinion ligjor përmes mediave, ai ka kërkuar takim zyrtar me kryesuesen e kuvendit e njëjta në takimin e parë ka premtuar se komunikimet zyrtare me Agjencinë Kundërkorrupsion do t'ia dërgoj në kopje fizike por më pas e ka ndërruar qëndrimin dhe edhe pse tri herë ka bërë kërkesa ende nuk i ka marrë komunikimet zyrtare që i ka pasur deputetja Melihate Basholli me Agjencioni Kundërkorrupsion. Kjo fshehje edhe për kundër obligimit ligjor, e bënë akoma më të dyshimit se ka pasur servime të cekur dhe falsifikime, krejt kjo ka bërë që të bie pre edhe Agjencia Kundërkorrupsion me opinionin e saj ligjor. Të nderuar anëtarë të kuvendit ai akoma më tutej kërkon që ti dërgohen në kopje fizike të gjitha komunikimet me organet e sipër përmendura, dhe se akoma ka hapësirë që të përmirësohemi, kemi nevojë ta ngritim cilësinë e punës. Mirëpo forma e komunikimit, forma e keqpërdorimit të detyrës, forma e falsifikimit dhe e plasimit të lajmit, fshehja e informatës janë të sanksionuara dhe janë të dënueshme. Ai nuk mund të pranoj më tutej që deputetja Basholli-Latifi të jetë kryesuese e kuvendit, pasi që ka humbur kredibilitetin e të qenurit kryesuese e kuvendit andaj pret që ajo të reflektoj konform shkeljeve ligjore, sepse ai akoma nuk e ka dërguar rastin në prokurori sepse ka dashur që të ruhet institucioni e kryesuese së kuvendit. Nëse edhe më tutej vazhdohet me avazin e vjetër ai shumë shpejt do të deponoj kallëzim penal për shkeljet ligjore keqpërdorim të detyrës zyrtare, tejkalim të kompetencave dhe prezantim të rrem e falsifikim të dokumentit apo komunikimeve zyrtare. Pastaj sqaroi se si anëtar i kuvendit ka qasje të papengueshme në dokumente, por kryesuesja e ka cilësuar se të klasifikuar komunikimet zyrtare të saj me institucionet e përmendura dhe këtë e ka bërë vet ajo. Konform Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare, ka dërguar shkresë tjetër të argumentuar, që nuk konsiderohet e mbrojtur dhe se nuk ka kompetencë dhe as autorizim, kryetari dhe nënkryetari i komunës dhe kryesuesja e kuvendit me i klasifikuar informatat dhe krejt kjo fshehje e opinionit dhe komunikimeve po bëhet me qëllimin e vetëm sepse e kanë qitë në lajthim institucionin të cilit i referohet. Andaj edhe më tutje kërkoi që ti dërgohen shkresat komunikimet zyrtare dhe atë konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe rregulloren e punës së Kuvendit dhe ligjeve tjera në fuqi. Ai kërkoi nga kryetari dhe nënkryetari i komunës që mos të sillen në mënyrë arbitrare duke ndikuar tek kryesuesja e kuvendit. Në fund bëri të ditur se kur ka kërkuar nga kryetari i komunës shkresat dhe komunikimin zyrtar me ministrinë e linjës, përgjigja e tij ka qenë se nuk i përzihet legjislativit apo kuvendit të komunës, dhe kjo për mendimin e tij është jo serioze dhe turpshme.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit- parashtroj disa kërkesa për fshatrat e artakollit: Fshati Stroc asfaltimi rrugës Ahmet Ademi në gjatësi 200 metra, Asfaltimi rrugës Maliq Hasani 200 metra, kanalizimi në rrugën 7 Dëshmorët gjatësi 700 metra, trotuari nga shkolla e fshatit në gjatësi 1 km. Në fshatin Beçuk shtrimi i rrugës Rexhep Murati me zhavor rrugë të rendit të VI gjatësi 600 metra. Fshati Zhilivodë Asfaltimi ose kubëzimi i segmentit Ahmet Krasniqi rrugica Fahri Krasniqi gjatësi 200 metra. Në fshatin Gllavatin Kanalizimi në rrugën Driton Islam Hasani në gjatësi 600 metra, shtrimi i rrugës Zenel Hajrizi 400 metra.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-duke ju referuar diskutimit të anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemi, vlerësoi se edhe ai ka parë nëpër media qarkullimin e një dokumenti sa i përket vlerësimit të pronave në parkun Industrial në Lumadh, dhe për këtë kërkoi që nëse ka vlerësimi dhe komunikime të tilla atë të dërgohen anëtarëve të kuvendit. Po ashtu kërkoi që në rend të ditës të futet procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të kuvendit.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të pranishmit, tha se sot do ta ngriti një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, përveç se e rëndësishme, edhe e domosdoshme. Çështja ka të bëjë me Parkun Industrial në Zonën Ekonomike, në Lumadh, zonë në të cilën Komunës së Vushtrrisë i është sjellë investim kapital prej 1.400.000 € nga MTI-ja, me qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve, duke i ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste, nxitjen e investimeve private në veprimtaritë prodhuese, hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave, qasje më të lehtë në transport, furnizim me energji, ujë dhe shërbime në mbështetje të biznesit, konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, Ligjit Për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159, Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 03/2014 dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020. Fatkeqësisht, në vend se Zona Ekonomike të jetë funksionale me qëllim zbatimin e kriterëve dhe arsyeshmërisë, Zona në fjalë i është nënshtruar një procesi të degradimit të plotë nga ana e pushtetit lokal të kaluar. Degradimi ka filluar nga Komisioni për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave, i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë të datës 26.11.2020, dhe vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit të datës 30.12.2020, duke vazhduar me aprovimin e vendimit NR. 81/21 e Kuvendit Komunal – Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në veçanti nga ana e dy ish-anëtarëve të Kuvendit në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të mbajtur më 16.04.2021 dhe duke përfunduar me ish-Kryetarin e Komunës, z. Xhafer Tahiri. Bazuar në këto vendime, Komisioni Vlerësues ka bërë shkelje të Ligjit Për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159 dhe të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 03/2014, *neni 5* Lokacioni i zonës ekonomike, *pika 1.3*, i cili shprehimisht flet për madhësinë e Parcelave. Në këtë rast i referohem Vendimit NR. 81/21, të datës 16.04.2021, me të cilin vendim u është lejuar dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme, duke mos u cekur në mënyrë shprehimore Numri dhe Madhësia e Parcelave për asnjërin biznes privat, përfitues të pronës së paluajtshme të zonës, por vetëm emri i kompanive përfituese. Më lejoni t’i paraqes në mënyrë kuantitative (sasiore) madhësinë e parcelave për secilin subjekt veç e veç: Me këtë rast i propozoj Kuvendit Komunal që në mbledhjen e radhës të futet në rend të ditës: Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit Komunal Nr. 81/21 të datës 16.04.2021, anulimin e të gjitha kontratave të kundërligjshme si dhe rikthimin e gjendjes së mëparshme të pronave të paluajtshme në Zonën Ekonomike - Parku Industrial në Lumadh.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pasi përshëndeti të pranishmit, ngriti shqetësimin e grupit të tij kuvendar për gjuhën e ashpër politike-gjuhë e rënd akuzuese për keqpërdorim të detyrave zyrtare, gjuhë kjo e cila po përdoret në kuvend, për projektin e quajtur si Zona Ekonomike në Fshatin Lumadh, i cili është propaganduar si projekti më i madh kapital në njëzet vitet e fundit në Komunën e Vushtrrisë. Për më tepër mungesa e transparencës dhe qasjes në dokumentet zyrtare është një qasje tejet jo demokratike për të cilën qeveria aktuale në fushat ishte zotuar se do ta zhbëj nga strukturat komunale. Përtej epilogut i cili nuk dihet e që vendimin përfundimtar e marrin institucionet e drejtësisë, e për çka ata nuk duan as që të interferojnë në të, vlerësoi se e drejta e një anëtari të kuvendit për të pasur qasje në dokumentet zyrtare është e drejtë ligjore e patjetërsueshme e cila nuk mund të mohohet. Për grupin e tij kuvendar është tejet shqetësuese kur një kuvendari nuk jepet qasje në dokumentet që kanë të bëjnë me komunën me interesin qytetar me kuvendin e komunës apo direkt me personi që është në interes. Nëse një asamblisti i mohohet kjo e drejtë për qasje në dokumente zyrtare atëherë çfarë mund të presin qytetar tjerë të thjesht. Me qëllim që të jemi transparent është mirë që anëtarët e kuvendit të njoftohen zyrtarisht me të gjitha vlerësimet që bëhen nga institucionet gjegjëse të drejtësi e në rastin konkret edhe për projektin e zonës ekonomike duhet të ketë informim kuvendi dhe jo anëtarët e kuvendit të njoftohen përmes

mediave. Në fund kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që të ketë parasysh obligimin ligjor lidhur me informimin e drejt dhe transparent sa i përket punës së kuvendit dhe vlerësimet nga institucionet tjera që i referohen punës së kuvendit të komunës.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se kur të vjen vendimi nga ana e ministrisë së linjës dhe organeve tjera të drejtësisë lidhur me projektin e zonës ekonomike, kërkoj që në kuvend të sillen të gjitha shkresat e dosjes që janë pjesë e këtij procesi. Në këtë kontekst vlerësoi se janë disa komisione ndërministrorë që merren me vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të komunave që prekin fushat e kompetencave të dy apo më shumë ministrive i themeluar nga MAPL-ja, andaj të gjitha shkresat e dërguar nga ministritë e linjës, bashkë me opinionin e Agjencisë Antikorrupsion të sillen para kuvendit dhe për këto të diskutohet, pasi që ka indikacione se disa anëtarë të kuvendit kanë pasur konflikt të interesit sa i përket votimit në kuvend por edhe në komision për parkun industrial në Lumadh. Prandaj me qëllim të kthjellimit të kësaj çështje është mirë që ato shkesa të vijnë në kuvend dhe kjo çështje të përmbillet.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e banorëve të fshatit Stanofc i Epërm, lidhur me bllokimin e kanalizimit në disa lagje. Pastaj lidhur me projektin Zona Ekonomike Lumadh, tha se ai projekt është dërguar për hetim në prokurori dhe duhet të pritet vendimi i organeve të specializuara për këtë çështje.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se lidhur me projektin Zona Ekonomike në Lumadh, është i pajtimit që të shkohet në proceduar të rregullta ligjore të vlerësimit, por jo duke u bazuar në elemente të shantazhit, të fshehjes kamuflimit dhe dhënies së informatave të falsifikuara, në mënyrë tinëzare dhe informata të paqëndrueshme në ligj. Pastaj meqë jemi duke diskutuar për ligjshmërinë e pronave dhe vlerësimin e ligjshmërisë, theksoj se komisioni për dhënien e pronës në shfrytëzim në Zonën Ekonomike ka bërë një punë të jashtëzakonshme dhe është investimi më i madh në pesëdhjetë vitet e fundit në Komunën e Vushtrisë, për të cilin edhe kjo qeveri duhet të japë maksimumin dhe ti gëzohet këtij projekti. Sidoqoftë kjo qeveri e ka filluar ndryshe në qasje në pengim të zhvillimit të bizneseve në pengim të posedimit të pronave konform ligjeve dhe kontratave dhe për këtë ai është i dëshpëruar dhe për këtë ai ka një propozim të shikohet rend me rend secila pronë se si janë dhënë në shfrytëzim. Mandej pyeti anëtarët e kuvendit se a kanë dëgjuar ndonjëherë për <banesat e varreve> banesat tek stacioni i autobusëve, ku ajo pronë është ndërruar me pronën komunale që ka qenë tek varrezat e martirëve është ndërruar me varre dhe kjo ka ndodhur kur ka qeverisur nomenklatura aktuale komunale. Andaj si është e mundur që të ndodh një ndërrim i tillë ku prona me ju dhënë kinse Bashkësisë Islame edhe të ndërrohet me varre në qytet dhe është deklaruar se proporcioni ka qenë 3/1 i këmbimit, por nëse është kështu atëherë nëse strukturat aktuale nëse pranojnë me i leshu shtëpitë e tyre për ndërrim me varre atëherë le të bëhet proporcioni 100 me 1 i ndërrimit dhe për këtë le të vjen raporti bashkërisht. Për këtë le të verifikohet se kush ka përfituar në këtë pronë, kush ka shitur, kush ka blerë kush merr qira të majme nga ajo pronë e të ngjashme dhe për këtë le të ngritet një komision dhe të bëj verifikimin një nga një të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, por e vërteta është se sponzorizues i këtij ndërrim ka qenë kryetari aktual i cili ka qenë në atë kohë kryesues i kuvendit, kryesuesja aktuale ka qenë deputetet e kuvendit në atë kohë. Andaj nëse mendohet të udhëhiqe në këto formë si ka filluar qeveria aktuale, atëherë ai nuk është me të, nëse mendohet të punohet për interesa të ngushta duke i priorizuar vetëm dy biznese ndërtimore, duke monopolizuar e duke ngulfatur biznesin, duke e ngushtuar rrethin në dy apo tre persona për ta shndërruar komunën në pronë private atëherë atë do ta kenë kundër.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-vlerësoi se nëse qeveria aktuale nuk dëshiron ta politizoj çështjen e zonës ekonomike, atëherë ajo duhet ta sjellë në kuvend këtë çështje për diskutim e shqyrtim në

një seancë të veçantë, për ta përmbyllur këtë temë dhe jo të diskutohet për gjatë muaj rresht në kuvend duke tentuar që çështja të politizohet e keqpërdoret. Mandej shtoi se ligjshmërinë e vendimeve të kuvendit e bënë MAPL-ja, dhe për vendimin në fjalë kjo e fundit ka dhënë përgjigje se vendimi në fjalë është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-propozoi që në kuadër të rendit të ditës të futet një pikë që lidhet me themelimin e një komisioni kuvendar për verifikimin e të gjitha pronave komunale, nga kush shfrytëzohen, cilat janë ato prona të uzurpuara, ku janë pronat e lira të komunës, sepse kjo është kërkesë e kamotshme e grupit kuvendar të LVV-së që të kemi identifikim të pronë komunale. Pastaj shtoi se komisioni i quajtur sipas tij hetimor, do të jepte një përgjigje do të hartonte një dosje për kuvendin që lidhet me pronën komunale.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-pasi përshëndeti të pranishmit, në mënyrë të përmbledhur u përgjigj në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit ku deklaroi se: kërkesat e parashtruara nga anëtari i kuvendit z.Behar Duraku, do të adresohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike për trajtim dhe shqyrtim dhe sipas mundësisë do të realizohen. Pastaj duke ju referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit z.Azemi dhe z.Lahu, të cilëve po ju korrespondojnë mendimet e tyre. Por çështja është se ai ka ardhur në qeverisje si kryetar komune qe pesë muaj dhe fajet nuk qëndrojnë tek ai sa i përket zonës ekonomike. Mandej vlerësoi se me gjithë modestin që ka, njoftoi se fajet dihet se ku janë, sepse lëshimet dhe shkeljet kanë ndodhur nga qeverisja e kaluar. Tutje shtoi se komplet shkresat e dosjes lidhur me projektin Zona Ekonomike në Lumadh, ia janë dorëzuar zyrës ligjore të komunës për opinion ligjor, dhe kjo e fundit ka gjetur se ka pasur shkelje sa i përket kontratave, sepse këto kontrata janë lidhur në kundërshtim me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, sepse këto kontrata janë uniforme dhe nuk janë hartuar nga ekspertet e komunës. Në fushatën paraelektorale i kishte ngritur temat për shkeljet që kanë ndodhur sa i përket këtij projekti, dhe të njëjtat i ka dorëzuar autoriteteve përgjegjëse gjyqësore. Agjencia Kundër-Korrupsionit e ka vlerësuar konfliktin e interesit gjatë procesit të vendimmarrjes, dhe mos të bëhet temë qasje në dokumentet zyrtare sepse ky proces është tërësisht transparent dhe krejt do të kenë qasje. Ai njoftoi se anëtari i kuvendit Ilmi Azemi, ka tentuar që të ndikoj tek ai për ta bindur kryesuesen e kuvend për ti dërguar emialat e komunikimit gjë e cila konsideron se nuk është në rregull që të publikohen dhe të dorëzohen. Lidhur me këtë çështje ai nuk dëshiron të implikohet sepse pushtet mes ekzekutivit dhe legjislativit janë të ndara. Sa i përket varrezave, që u apostrofuan, sqaroi se komuna ka obligim të siguroj lokacion për varreza, dhe ajo se çfarë ka ndodhur është se martirë të vrarët dhe të masakruarit nga lufta e fundit, janë varrosur në një parcelë që është pronë e Bashkësisë Islame, dhe kjo e fundit ka kërkuar kompensim dhe se në këtë proces çdo gjë ka shkuar përmes komisioneve të pavarura dhe se çdo gjë kishte qenë sipas ligjit, për këtë ekzistojnë dokumentet. Gjithçka që ka dikush e që e implikon atë në ndonjë proces të dyshime kërkoi që ti thuhet këtu në kuvend, por kushdo që mendon se ka votuar atë për të përfituar ndonjë interes personal, ai nuk lejon dhe e ka bërë të qartë e edhe në fushatë se nuk lëshohet në kësi lloj raportesh, dhe askujt nuk i ka premtuar ndonjë gjë dhe se askënd nuk e ka gënjyer. Pastaj ceku se e përkrah propozimin që të themelohet komision për verifikimin e pronave dhe të sqarohet çdo gjë e cila është paqartë. As projektin e apostrofuar dhe asnjë projekt tjetër nuk e ka përdor dhe nuk do ta përdor politikisht, por realisht dhe sinqerisht deklaroi se është 99 herë është i lidhur me qytetarin ndërsa 1 herë me partinë që e ka kandiduar për kryetar komune. Në fund tha se ai nuk shantazhohet dhe nuk i nënshtrohet shantazheve për votimin e pikave në kuvend, sepse krejt pikat që i sjell para kuvendit janë për qytetarët dhe jo për interesat e dikujt tjetër andaj mbetet në vullnetin e anëtarëve të kuvendit se ai përkrahin apo jo, por e vërteta dhe zotimi i tij është se do të ketë zero tolerancë në keqpërdorimin e detyrës zyrtare dhe parasë publike.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se kërkesat që ai i ka parashtruar duhet marr me qetësi, nuk ka nevojë që kryetari i komunës të tensionohet. Pastaj shtoi se është shqetësuese qasja e trajtimit të akteve të plotfuqishme juridike që janë aprovuar nga institucionet gjegjëse. Mandej qeveria duhet pasur parasysh se opinioni ligjor nuk është vendim. Ky opinion ligjor është i nxjerr nga Agjencia Kundërkorrupsion është marr në lajthim dhe bazuar mbi faktet të falsifikuara të janë dal nga komuna, dhe për këtë nga agjencia do të merret një vendim që ai opinion do të hedhet poshtë.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se vendimi për përkrahje financiare të klubit të futbollit duhet të plotësohet edhe me përkrahjen e disa klubeve tjera sportive, kjo për faktin se në gjitha qeveritë e kaluara ka pasur kësi lloj gabime duke i mbështetur në mënyrë selektive disa klube sportive dhe disa OJQ dhe duke pamundësuar që disa klube tjera të zhvillojnë veprimtarinë e tyre dhe kjo ka bërë disa klube të shuhen. Konkretisht klubi “Shqiponja” dhe klubi i shahut “Shqiponja” që ishin klube me renome jo vetëm nacionale por edhe ndërkombëtare dy herë përfaqësim i Kosovës në ligën e kampionëve në Bullgari dhe Slloveni, pra janë këto klube në lokalitetin ku ai jeton, ndërsa ka edhe plot klube tjera që janë shuar. Në bazë të vendimit të kuvendit Nr.210/21 i datës 05.10.2021 shuma totale e mjeteve financiare për përkrahje është 200,000.00 €, andaj në këtë përkrahje duhet të futen të gjitha klubet sportive dhe shoqata për përjashtim, nëse mendohet që ky vendim të ndryshohet dhe plotësohet. Propozoi që këto mjetet të merren nga Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në vlerën prej 190,000.00 € nga të hyrat e bartura

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se e përkrah idenë që të themelohet një komision për verifikimin e pronave komunale, ashtu që të hedhim dritë lidhur me prona që i posedon komuna. Pastaj ka shumë prona komunale që janë uzurpuar nga keqbërës, dhe këto prona duhet të lirohen sa më parë që të jetë e mundur. Kadastra e komunës duhet të ndërmarr veprime për lirimin e pronë komunale nga uzurpatorët e pandërgjegjshëm.

Albanez Tahiraj, drejtor i DGJKP-njoftoi kuvendin se për herë të parë nënë udhëheqjen e kësaj qeverie, është publikuar lista e të gjitha pronave të komunës në faqen zyrtare të komunës, aty kanë qasje të gjithë se mund të analizohen dhe kontrollohen pronat e komunës, ashtu siç që moti e ka kërkuar ligji po që tani ka ardhur në shprehje zbatimi i ligjit.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se është bërë e mundur që kjo lista me të gjitha pronat e komunës të publikohet, kjo është një lajm i mirë për komunën. Por sipas tij një gjë e tillë është e pamundur, pasi që komuna ka shumë prona dhe evidentimi ti të gjitha rrugëve në qytet dhe fshatra, mandej pronat e uzurpuara të cilat në kopje fizike do të jetë vështirë të paraqiten, e lëre më të përshkruhen në një data-bazë elektronike. Nëse një gjë e tillë është realizuar ai e përgëzon Drejtorin e Drejtorisë së Pronës, por ai duhet ta prezantoj këtë gjë para kuvendit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se është mirë të formohet komisioni për verifikim të pronës, ashtu që të evidencohet se kush ka uzurpuar pronë komunale, kush ka keqpërdorur, kush shfrytëzon pronë pa paguar qira e të ngjashme. Kjo duhet të sepse është obligim ligjor dhe komuna ka mungesë të pronës. Propozoi që të futet në rend të ditës formimi i këtij komisioni.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-kërkoi që pjesë e këtij vendimit për formimin e komisionit të jetë edhe një pikë që flet për tejkalimin e shfrytëzimit të parcelave private tek ndërtimi i objekteve kolektive-banesore, sepse dihet fakti se kemi shfrytëzim të parcelave deri në 150 % dhe të dihet se për cilat prona bëhet fjalë.

Albanez Tahiraj, drejtor i DGJKP-duke ju referuar diskutimit të anëtarit të kuvendit z.Adnan Lahu, sqaroi se ai nuk mund ta bëjë të dukshmen dhe të prekshmen të padukshme dhe të prekshme, për faktin se ajo çfarë deklaroi ai është dukshme dhe e prekshme dhe e njëjta e publikuar në faqen zyrtare të komunës e cila mund të printohet dhe se në atë listë mund të kenë qasë të gjithë qytetaret

e Komunës së Vushtrrisë. Për këtë mund të adresohen tek zyrtari i IT dhe mund të qasen në listën e pronave e cila është publikuar së fundmi në faqen zyrtare të komunës.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se duhet pasur memorie institucionale për faktin se është pikërisht Partia Demokratike e Kosovës në Vushtrrisë që më datën 06.10.2021 kishte thirrur një seancë të jashtëzakonshme ku ishte aprovuar vendimi për subvencionimin e klubeve sportive dhe shoqatat tjera në vlerën prej 200,000.00 €. Por tani kemi para vetës një propozim-vendim ku në pikën katër të tij thuhet shfuqizohet vendimi i kuvendit me Nr. protokollit 210/21 për subvencionim të klubeve, lidhur më këtë ai kërkoj që pika katër të hiqet nga ky propozim-vendim dhe i njëjti të shqyrtohet si pikë e tret e rendit të ditës.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-dha sqarime lidhur me propozim-vendimin për subvencionimin e klubit të futbollit “Vushtrria”, duke shtuar se të gjitha klubet e sportit, shoqata e luftës dhe shoqata tjera janë mbështetur financiarisht dhe të një njëjta do të mbështeten edhe në të ardhmen. Për këto subvencion janë shpallur thirrjet publike, dhe shtrohet pyeta se përse është veçuar klubi i futbollit sepse tani jemi në 100 vjetron e themelimit të klubit dhe të gjithë jemi zotuar se do ta mbështesim klubin brenda mundësive financiare që iu kemi si komunë. Prandaj është shumë emergjente ndarja e këtyre 50,000.00 €, ndërsa me vendimin që është sjellë për shfuqizim kanë qenë 22,500.000 €, ky vendim ishte marr në kohë fushate dhe ka pasur defekte sa i përket ligjshmërisë se këtij vendimi sepse mjetet janë marr nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale në mënyrë kundërligjore, prandaj ky vendim duhet të shfuqizohet

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se duhet dhënë sqarimet për pikat dhe temat para së të aprovohet rendi i ditës, sepse është pikërisht PDK në Vushtrri e cila në kohë fushate dhe me pompozitet ka sjellë një propozim –vendim për subvencionimin e klubeve dhe shoqatave, dhe tani duke kamufluar subvencionimin e klubit të futbollit ka sjell shfuqizimin e vendimit 210/21 i aprovuar vitin e kaluar, andaj kërkoj që kjo pikë për shfuqizimin e atij vendimi të hiqet nga propozim-vendimi. Ndërsa lidhur me përkrahjen e klubit të futbollit kërkoj që vlera e mjeteve të rritet në 100,000.00 € ashtu siç kishte premtuar kryetari i komunës dhe vetëm në këtë formë do ta përkrahin si grup kuvendar.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit-tha se akoma jemi në diskutimet jashtë rendit të ditës ndërsa, tani po diskutohet për rendin e ditës për heqjen dhe shtimin e ndonjë pike në rend të ditës. Pastaj po thuhet se vendimi për subvencionim të klubeve dhe shoqatave me 200,000.00 € i aprovuar vitin e kaluar është aprovuar kundërligjshëm, por tani kur është sjell vendim për subvencionim të klubit të futbollit a është kundërligjshëm i procedura.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-sqaroi se dallim është në atë se vendim i cili është marr vitin e kaluar për subvencionimin e klubeve sportive dhe shoqata tjera, mjetet financiare janë marr nga kategoria mallra dhe shërbime dhe nga investimet kapitale, gjë e cila e bënë këtë vendim kundërligjor, ndërsa vendim aktual për përkrahjen financiare për klubin e futbollit kostoja e tij mbulohet nga subvencionet që është kategori ligjore e specifikuar për këto çështje.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-propozoi që pika 8 dhe 9 të rendit të ditës, të hiqen nga rendi i ditës pasi që këto pika nuk janë hartuar në koordinim me anëtarët e kuvendit dhe të njëjta nuk kanë kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, gjë e cila është obligim ligjor që fillimisht pika ti shqyrtoj KPF-ja, nëse këto votohen sot ai do jetë kundër, por edhe nëse aprovohen të njëjta ai do ti ankimojë me shkresë zyrtare në MAPL. Pastaj vlerësoi se nuk ka qenë në praktikën e PDK-së, që të ushtoj preson tek anëtarët e kuvendit. Por se në rastin e kësaj seance ka ndodhur e kundërta që është ushtuar preson nga kryetari nënkryetari i komunës dhe kryetari i Degës së PDK-së në Vushtrri, ku janë thirru në telefon dhe iu është kërkuar që të votojnë pikat e rendit të ditës. Trysnia

presioni dhe shantazhi janë të ndaluar me ligj dhe trysni ka pasur kohëve të fundit ndaj deputetëve të PDK-së.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-duke aluduar tek diskutimi i anëtarit të kuvendit z.Ilmi Azemi, sqaroi se kush do që ka dijen për forma të ushtrimit të trysnisë dhe shantazhit është mirë ti bëjë të ditura para anëtarëve të kuvendit dhe para gjithë qytetarëve por edhe ti denoncoj në organet e drejtësisë. Ai tha se nëse dikujt i ka bërë trysni ata le të deklarohen sepse nuk ka bërë dhe nuk është në natyrën e tij për të bërë gjëra të tilla. Përdorimi i këtyre shprehjeve shantazh e presion nga anëtari i kuvendit nuk është i duhur për më tepër është diskutim koti dhe që nuk i bënë nder të thuhet para qytetarëve.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-konfirmoj se janë thirrur të gjithë deputet e PDK-së për të ju bërë trysni, me përjashtim të Lorik Maxhunit, Nurie Halilit dhe Ilmi Azemit.

Blerina Shala, anëtare e kuvendit-deklaroi me bindje të plotë se askush nuk e thirru në telefon për ti ushtruar presion për të votuar pikat e rendit të ditës.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pikat e rendit të ditë që lidhen me bartjen dhe tejkalimin e mjeteve financiare, nuk kanë kaluar në filtrin kryesor që është Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe kësaj këto pika duhet të hiqen nga rendi i ditës, sepse KPF-ja është forumi kryesor i shqyrtimit të politikave dhe dokumenteve financiare komunale. Në këtë rast duhet të kemi një rol më aktiv të drejtorit të drejtorisë i cili duhet të jap sqarimet e duhura për politikat dhe dokumentet financiare dhe për impaktin zhvillimor të këtyre dokumenteve, që lidhen me bartjen e mjeteve financiare të komunës.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se sa i përket propozim-vendimeve për bartjen dhe tejkalimin e të hyrave vetanake të komunës, ka gabime teknike dhe substanciale, dhe kërkoi që herëve tjera të mos përsëriten. Me qëllim të nxënies së afatit dhe me mos bllokimit të punës së komunës ata si grup kuvendar do ti përkrahin këto propozim-vendime.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që ta respektoj rregulloren e punës të kuvendit, për sa i përket votimit të propozimeve të dhëna nga anëtarët e kuvendit, duke i qitur në votim, dhe duke mos bërë shkelje ligjore duke iu mohuar anëtarëve të kuvendit të drejtat e tyre që burojnë nga rregullorja. Ai vlerësoi se është e patjetërsueshme e drejta e deputetëve të kuvendit të komunës për të bërë propozime dhe për ti votuar ato, tërhiqi vërejtje se është duke u shkelur rregullorja e punës në mënyrë flagrante.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 1 votë “kundër” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 mars 2022;
2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
3. Shqyrtimi Propozim – vendimit për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e futbollit “Vushtrria”
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane;
5. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me Draft-Rregulloren për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane;

6. Shqyrtimi i Raportit të aksionarëve për punën njëvjeçare të Ndërmarrjes regjionale për menaxhimin e mbeturinave “Uniteti”;
7. Shqyrtimi i kërkesës i Këshillit të Bashkësisë Islame lidhur me rishikimin e memorandumit për shërbime të varrimit;
8. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për lirim nga pagesa e taksës komunale për kiosqet nga druri;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021;
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;
11. Shqyrtimi Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtri;
12. Shqyrtimi Propozim – vendimit për formimin e komisionit për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;
13. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 mars 2022;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 mars 2022.

2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-tha se raporti tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, nuk duhet të kaloj pasi që i njëjti nuk është i kompletuar dhe mund të thuhet se është i nivelit skandaloz, për faktin se janë bërë krahasime të tre mujorit të parë të vitit 2022 me raportin e vitit 2021 tek tabelat sa i përket mallrave dhe shërbimeve, pastaj mungon faqja e dyte ku është dashur të jetë tabela me të dhënat për kategorinë mallra dhe shërbime, komunal, subvencione dhe tabela për investime kapitale. Meqë kemi të bëjmë me një dokument zyrtar i cili do të publikohet në faqen zyrtare të komunës ashtu edhe siç është cekur në dispozitat ligjore, mendon se ky raport duhet të kompletohet dhe më pas të silllet në kuvend.

Remzi Ahmeti, drejtor i DBF-së-tha se ato që i deklaroi anëtarja e kuvendit do të inkorporohen në raport.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-kërkoj që raporti tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të shtyhet sepse nuk është i përgatitur si duhet.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi kjo pikë e rendi të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi Propozim – vendimit për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e futbollit “Vushtrria”

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se askush nuk është kundër që ti dilet në përkrahje klubit të futbollit, sidomos në jubileun e tij në 100 vjetorin e themelimit të tij. Por nuk është mirë të ngutemi të marrim vendime populliste dhe kundërligjore. Vendimi i cili ishte marr vitin e kaluar

për subvencionimin e klubeve sportive dhe shoqatave në vlerë prej 200,000.00 € është një vendim i mirë por vështirë i realizueshëm. Por ajo çka është e rëndësishme është fakti se rregullorja e komunës për subvencionet përcakton se çdo përkrahje financiare në vlerë për mbi 500 € duhet të aplikohet përmes thirrjes publike, dhe praktika e ndarjes së përkrahjes financiare për klubet dhe OJQ-të e ndryshme përmes kuvendit ka qenë vetëm para vitit 2017, sepse prej se ka hi rregullorja në fuqi është obligative të kemi thirrje publike. Si kuvend mund ti propozojmë 50,000.00 € për klubin e futbollit si zë buxhetor por më tej financimi duhet të bëhet përmes thirrjes publike. Në të kundërtën nëse aprovojmë mjete financiare vetëm me vendim të kuvendit atëherë po detyrohemi të bëjmë shkelje ligjore si anëtarë të kuvendit dhe kjo është situatë tejet e pa lakmueshme. Andaj propozoi që ky vendim ta ketë edhe një pikë shtesë ku precizohet që të gjitha këto mjete do të ndahen përmes thirrjes publike duke respektuar rregulloren në fuqi dhe udhëzimin administrativ të Ministrisë së Financave.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-kërkoj që pika 4 e këtij propozim-vendimi të hiqet nga propozim, e nëse janë konstatuar shkelje ligjore atëherë në një seancë tjetër mund të silllet propozim për shfuqizimin e atij vendim, sepse nëse një vendim është jashtë fuqisë ligjore atëherë përse kemi nevojë që një vendim të tillë ta shfuqizojmë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-kërkoj që pika 4 e këtij propozim-vendimi të hiqet nga propozim, të rregullohet struktura ligjore e propozim-vendimit e më pas të diskutohet shuma e mjeteve financiare për përkrahjen e klubit të futbollit.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se vendim në vlerë prej 200,000.00 €, nuk është i publikuar në faqen zyrtare të komunës, si i tillë ai vendim është jo ligjore dhe kërkoj në këtë kontekst përkrahjen e anëtarëve të kuvendit që ti dilet në ndihmë klubit të futbollit pas që dëshira është për të hyrë në super ligë.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se në bazë të rregullores për subvencione, përkrahja financiare mbi 500 € bëhet përmes thirrjes publike, andaj nëse ka dilema ligjore atëherë le të dërgohet për marrjen e opinionit në zyrën ligjore, apo MAPL-së.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-kërkoj nga kuvendit që ta aprovojnë më votë këtë propozim-vendim ashtu siç është sjellë, sepse për të gjitha klubet sportive të tjera dhe shoqata është shpallur thirrja publike, ndërsa është imediate të aprovohet ndihma financiare për klubin e futbollit “Vushtrria” në vlerë prej 50,000.00 €. Ndër të tjera propozoi që të shtohet edhe zyra e kryetarit si pozicion ekonomik, që do ta mbuloj koston e këtij vendimi.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se e kupton qëllimin e mirë për ti dal në ndihmë klubit të futbollit, njëjtë mendon se duhet ndihmuar klubi, mirëpo duke respektuar rrugët ligjore, dhe propozoi që shuma të rritet në 150,000.00 €, më qëllim që mundësohet që klubi të përmbush obligimet që i ka ndaj ATK-së dhe obligimet tjera që i ka si klub. Nëse klubi arrin ti përmbush obligimet ndaj ATK-së, atëherë komuna nuk do ta ketë problem që ta ndihmoj klubin përmes thirrjes publike. Presoni që është duke u bërë që subvencionimi i klubit të bëhet përmes kuvendit, është për faktin se klubi nuk mund të përkrahet përmes thirrjes publike për shkak të dokumentacionit që nuk e ka të kompletuar dhe për shkak se nuk ka ofruar raport disa vite më radhë. Në kuptimin figurativ njoftoi se dëshiron të “heqë dushkun komplet” se komuna ka marr vërejtje të vazhdueshme nga auditori gjeneral, kemi dal nëpër portale, jemi raportuar nga kllxo.com, dhe nëse vërtet dëshirojë ta ndihmojmë klubin atëherë rriteni subvencionet që ai ti paguan obligimet në mënyrë complete, dhe mandej nuk do të jetë problem që edhe vitin e ardhshëm të ndihmohet klubi, dhe kështu do të lehtësohet raportimi, sepse në çfarëdo forme që subvencionohet qoftë përmes kuvendit apo me thirrje publike, klubi duhet të raportoj sepse mbështetja po bëhet me para publike. Edhe nëse i ndajmë këto 50,000.00 €, kujt do ti raportoj

klubi. Andaj bëri thirrje që të rritet shuma e subvencioneve për klubin, dhe kështu klubi i futbollit, paraprakisht ka të drejtë të lidh marrëveshje me ATK-në që obligimet të kryej me rata. Në këtë rrjedh askush nuk do të ketë problem dhe do të zgjidhje forma e financimit të klubit. Në të kundërtën nuk është mirë që në këso forma të qitet në lajthitje kuvendi, sepse ajo në cilësinë e drejtoreshës së DKRS-së i kishte lutur zyrtarët e klubit që ti përmbushin obligimet e klubit, por asokohe kishte ekzistuar një rrëmujë në funksionimin e klubit. Në fund tha duhet gjetur një rrugë afatgjatë për financimin e klubit të futbollit, sepse klubi nuk mund të përfitoj subvencion përmes thirrjes publike për shkak të dokumentacionit, dhe nëse i ndajmë mjete financiare përmes kuvendit ajo është e ngjashme sikurse mjetet do të ndante Drejtoria e Kulturës dhe atëherë do të shtrohej dilema se kujt do ti raportonte klubi për shpenzimin e parasë publike.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit –konstatoj se në bazë të sqarimeve të bëra jenim të obliguar që pikën 4 ta heqim nga propozim-vendim, sepse është mendim i përgjithshëm se vendim i tillë është jashtë fuqisë ligjore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-vlerësoi se forma imponuese tek anëtarët e kuvendit në këtë rend të ditës është e papranueshme dhe krijon precedent të paparë, sepse kuvendi nuk është konstituar për herë të parë por ai funksionon për vite të tëra. Nga anëtarët e kuvendit pati propozime të ndryshme ku po kërkohet të hiqet pika 4 e propozim-vendimit, ku deputetët nuk po pajtohen që të shfuqizohet vendimi i kuvendit i me numër 210/21 i datës 06.10.2021 për subvencionimin e klubeve sportive dhe shoqatave tjera dhe për këtë deputetët kanë plotësisht të drejtë. Pastaj vlera për klubin e futbollit duhet të rritet në 100,000.00 € për përkrahje financiare dhe duhet të hiqet pika 4 e propozim –vendimit.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se klubet sportive dhe shoqata tjera janë futur për subvencionim përmes thirrjes publike. Për klubin e futbollit ka përjashtime sepse është imediate ta ndihmojmë atë. Më tej sqaroi se janë mbështetur 400 të ri dhe të reja, janë rritur bursat e studentëve prej 55 në 70 bursa, janë planifikuar edhe 10,000.00 € për studentët që studiojnë në vendet e ndryshme të Evropës. Për herë të parë është planifikuar subvencionimin e qumështit me 4 cent për litër, subvencionimi i ujitjes së tokave që janë nënë sistemin e ujitjes me 50% , këto janë të gjitha votat dhe është vullneti i deputetëve që kah ti orientojnë këto mjete. Në vendimin që u tërheqë pika 4 për klubin e futbollit ishin ndarë 22,000.00 € ndërsa tani po rritet kjo shumë në 50,000.00 €.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-kërkoi të jepet një mendim nga zyra ligjore se një propozim-vendim i tillë a është në suaza të ligjit, ndërsa është mirë të shikohet dhe duhet të shikohen mundësit financiare të komunës, dhe konform mundësive të subvencionet klubi i futbollit “Vushtrria”.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se ky vendim duhet të aprovohet dhe nëse ka shkelje ligjore ato do ti konstatojnë MAPL-ja, ndërsa ai propozon që shuma financiare të rritet në 100,000.00 € ashtu siç ka qenë premtimi i kryetarit të komunës dhe ashtu siç ka qenë e inkuorporuar në aprovimin e buxhetit të komunës.

Sylejman Mehollli, anëtar i kuvendit-duke u nisur nga diskutimit i kryetarit të komunës, tërhiq vërejtjen për deklaram për shkelje ligjore, ku vlerësoi se deklaramet e kryetarit të komunës mund të kualifikohen si shkelje të ligjit me paramendim dhe të njëjtat mund të sanksionohen, andaj sugjeroi të ketë kujdes në deklarime publike në kuvend. Ai përsërit se subvencionimi i klubit duhet të bëhet përmes thirrjes publike duke respektuar udhëzimin administrativ dhe rregulloren komunale për subvencione. Në të kundërtën përpos kryetarit të komunës edhe kuvendi do të bartë përgjegjësi për votimin e një vendimi të tillë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se klubet sportive dhe OJQ janë subvencionuar përmes thirrjes publike, por në rastin e klubit të futbollit gjithëherë është ndihmuar përmes kuvendit dhe këtu nuk sheh kurrfarë shkeljesh ligjore. Përsëriti se duhet të rritet shuma financiare në 100,000.00 €, në këtë kontekst shtoi se mjetet mund të sigurohen nga pozicioni zyra e kryetarit, dhe vlerëson se po të mos ishte ndihmuar klubi përmes kuvendit atij do të rrezikonte mos të ekzistonte fare. Bëri thirrje që të rritet shuma dhe ta votojnë të gjithë anëtarët e kuvendit.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-kërkoj të votohet vlera financiare prej 50,000.00 € përkrahje financiare për klubin e futbollit, ndërsa gjatë vitit të shikohet mundësia për ta ndihmuar sërish klubin.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit –në rekapitullimin e debati lidhur me këtë propozim vendim konstatoi se hedhet në votim propozim-vendim për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e futbollit “Vushtrria”, duke hequr pikën 4 të propozim dhe që vlera financiare e subvencionit të jetë 50,000.00 € konform mundësve financiare të komunës, dhe kërkoi që deputet që janë në konflikt të interesit eventual të tërhiqen nga votimi.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-deklaroi se si anëtar i kryesisë së klubit, dhe me qëllim të shmangies eventuale të konfliktit të interesit nuk do të marr pjesë në votim.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 29 vota “për”, 2 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë prej pesëdhjetë mijë euro (50,000.00 €) për Klubin e futbollit “Vushtrria” në Vushtri.

2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se themelimi i këshillave të fshatrave derivon nga udhëzimi administrativ 02/2019 i MAPL-së ku janë përcaktuar kriteret e numrit të këshillave të fshatrave konform numrit të popullsisë, ku neni 4 përcakton: Organizimi dhe funksionimi i këshillave lokale, Komuna themelon këshillat lokale në bazë të numrit të banorëve si vijon: Deri në 10.000 banorë, komuna duhet të ketë deri në katër (4) këshilla lokale; Prej 10.001 mijë deri në 20 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në tetë (8) këshilla lokale; Prej 20.001 deri në 30 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në dymbëdhjetë (12) këshilla lokale; Prej 30.001 mijë deri në 50 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në njëzet (20) këshilla; Prej 50.001 mijë deri në 70 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në njëzet e pesë (25) këshilla lokal; Prej 70.001 mijë deri 100 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në tridhjetë(30) këshilla; Komunat me mbi 100.001 banorë, komuna duhet të ketë deri në dyzetë (40) këshilla. Neni 6 i draft-rregullores përcakton se Komuna e Vushtrris mund të themeloj deri në 22 këshilla lokal, mendon se duhet të shtohet numri i këtyre

këshillave lokal në qytet sepse numri i banorëve në qytet është përafërsisht i njëjtë me numrin e banorëve që gravitojnë nëpër fshatrat e komunës dhe se vetëm 4 këshilla lokal në qytet janë pak kur e krahasojmë me numrin kaq të madh të banorëve dhe propozoi që numri të rritet në 6 apo eventualisht 7 këshilla në qytet. Tek neni 5 i draft-rregullores ku thuhet se: Kuvendi i komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë, katër (4) anëtarë nga Kuvendi i komunës, një (1) nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Ky përfaqësues zgjedhet ad-hoc nga komisioni. Në këtë kontekst propozoi që fjala zgjedhet nga komisioni të hiqet nga ky nenë, pasi që ky anëtar duhet të zgjedhet nga qytetarët e këshillit të fshatit. Pastaj fokusi duhet të jetë tek neni 9 ku thuhet se: Kandidatët për anëtarë dhe kryetarë të këshillave lokale nuk mund të jenë kandidatë nëse janë të zgjedhur apo të emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve politike, si subjekt politikë e përkrahin plotësisht këtë sanksionim ligjor me qëllim të depolitizimit të këshillave të fshatrave. Pastaj tek neni 17 pika 4 thuhet: Kompensimi bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit sipas nenit 13, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje. Ndërsa neni 13 i ka vetëm 3 pika apo paragrafë, e që në këtë rast duhet të përcaktohet se kompensimi bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit sipas nenit 14 të rregullores.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-kërkoi që në këshillin lokal Bukosh, Dalak, Shtitaricë, të kemi një veçim që fshati Bukosh të ndahet si këshill i veçantë, ndërsa fshati Dalak dhe Shtitaricë të jeni në një këshill të përbashkët ashtu siç është kërkesa e banorëve të këtyre fshatrave.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se është shumë e nevojshme që të bëhet emërtimi i lagjeve urbane në qytetin e Vushtrrisë, kjo për shumë arsyes sepse qyteti është zgjeruar, dhe me qëllim të orientimit dhe adresimit të saktë në lagjet e caktuar, për shkak të aspekti të turizmit, atij historik, demografik dhe zonimit ekonomik e shëndetësor të qytetit. Andaj propozoi që kjo pikë të shtyhet për ndonjëherë nga mbledhjet e radhës, të themelohet një komision profesional dhe të shfrytëzohet kjo rregullore për zoonimin dhe emërtimin zyrtar të lagjeve të qytetit.

Hava Rruka-Mlinkau, drejtoreshë DA-së-paraqiti sqarime se posa të formohet komisioni i paraparë me rregullore, do të bëhet zononimi i lagjeve dhe ndarja e kufive kadastale-ndarja territoriale e qytetit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-shprehu nevojën që nëpër bashkësitë lokale të kemi shoqëri kulturo-artistike, dhe kërkoj nga Drejtoria e Kulturës që ta ketë parasysh këtë.

Fatmir Feka, zyrtar ligjor-dha sqarime për temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Lidhur me formimin e komisionit sqaroi se përbërja e tij është detyrim ligjor nga udhëzimi administrativ.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se duhet të bëhet dallimi mes qëllimit dhe fushëveprimit të kësaj rregulloreje. Pastaj në suaza ligjore edhe 3 apo 4 këshilla lokale do të duhej të themelohen në qytet për shkak të numrit të banorëve. Pastaj përkrah idenë e emërtimit të lagjeve urbane në qytet dhe ngritjen e një komisioni profesional për këtë qëllim.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit-tha se hartimi i kësaj rregulloreje ka zënë fill në kohën kur ai ishte drejtor i Drejtorisë për Administratë për çka i gëzohet këtij fakti. Më tej shtoi se shpreson që këshillat lokale të mos jenë të politizuara ashtu që të kemi zbatim të nenit 9 të kësaj rregullore, që ka përjashtuar që pjesë e këshillave lokale të jeni anëtarë të strukturave partiake.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-kërkoi nga komisioni që ta ketë parasysh e këshillin lokal në Bukosh, ashtu që ai të jetë në bashkim me fshatin Novolan.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ka bashkëpunuar me komisionin sa i përket hartimit të kësaj rregulloreje, dhe vlerëson se problematike do të jetë zbatimi i nenit 9 ku thuhet se: Takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë së paku 30 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti,

duke respektuar kuotën gjinore prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, dhe përfaqësimin etnik në lokalitete ku ka banorë të komuniteteve joshumicë. Kjo për faktin se nuk është gatishmëria e larët e qytetarëve për të marr pjesë në themelimin e këtyre forumeve dhe kjo është provuar nga praktikat e kaluara. Ky përkufizim propozon të jetë të trajtën dëshirore për faktin se do të jetë shumë e vështir që një kuotë e tillë të përmbushet.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se kjo draft-rregullore duhet të aprovohet sot për faktin se nga dispozitat e udhëzimit administrativ del obligimi që komunat janë të obliguara brenda afati prej gjatë muajsh ti hartojnë rregulloret komunale, ndërsa udhëzimi ka hyrë në fuqi në vitin 2019. Për më tepër këshillat lokale janë formuar në vitin 2017 dhe atyre iu ka kaluar ma mandati, andaj është shumë e nevojshme aprovimi i kësaj rregulloreje.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, në saj të konkluzioneve të nxjerra nga anëtarët e kuvendit, në mënyrë “unanime” u vendos që kjo pikë të shtyhet për ndonjërin nga mbledhjet e radhës, për formimin e komisionit profesionalë dhe inkorporomini e ndryshimeve për emërtimin dhe zoonimin e lagjeve urbane të Qytetit të Vushtrrisë dhe të njëjta të jenë pjesë e rregullores.

5.Shqyrtimi i Peticionit lidhur me Draft-Rregulloren për Organizmin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-evidentoj disa gabime teknike në peticion sa i përket numrit të faqeve por edhe numrave rendor, kërkoj që i njëjti të kompletohet.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë **28 prill 2022**, ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fshatit Lumadh të parashtruar në emër z. Avni Zabelit, që lidhet me kërkesën e tyre që fshati Lumadh të ketë këshill lokal të veçantë ose t'i bashkëngjitet një fshati me numër të banorëve më të vogël, ashtu që të shmanget mbivotimi në këshill në proceset vendimmarrëse, andaj Kuvendi i komunës pas një analize të hollësishme, komisionit të lartcekur i parashtron këtë:

Kërkesë

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga Komisioni komunal për hartimin e Draft-rregullores për Organizmin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, që të shqyrtojë dhe analizojë me kujdes kërkesat që dalin nga peticioni i cekur më lart konform legjislacionit në fuqi, si dhe duke marrë për bazë interesin qytetar të marrë vendim për kërkesat që derivojnë nga peticioni.

Obligohet komisioni i cekur më lart që të jepë përgjigje me shkrim brenda afatit ligjor dhe për të njëjtën ta njoftojë parashtruesin e peticionit.

6. Shqyrtimi i Raportit të aksionarëve për punën njëvjeçare të Ndërmarrjes regjionale për menaxhimin e mbeturinave “Uniteti”;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ky raport duhet të sillet në kuvend përsëri, pasi të aprovohen pasqyrat financiare të Kompanisë “Uniteti” sepse këtu mungon edhe raporti i auditorit për pasqyrat financiare, andaj në rastin konkret kryeshefi ekzekutiv mund të tregoj në raport të shpërfaq dokrra dhe çështje të fontanë dëshirash duke shkruar shifra pa kurrfarë baze. Ky raport ka shënime tepër të pasakta dhe nuk ja vlen të merremi fare me të. Ka shifra jo reale, nuk janë paraqitur të gjitha detyrimet kontingjente që i ka kompania. Qëndrueshmëria ekonomike e kësaj kompanie nuk është e stabile, por këtu në raport paraqiten insinuata imagjinare për gjoja sukses në qëndrueshmërinë e ndërmarrjes. Pastaj pyeti se pas emërimit të anëtarëve të komisionit të aksionarëve nga Komuna e Vushtrrisë, pyeti se çfarë po ndodh në procedurat e mëtutjeshme në Kompaninë “Uniteti” dhe “Përparimi”. Pyetja qëndron se çka kanë ndërmarr komisioni i aksionarëve a ka filluar me emërimin e anëtarëve të bordit dhe cilat politika si komunë do ti zhvillojmë rreth këtyre dy kompanive. Atje kemi pasur bordet ekzistuese dhe marrja e pushteti nënkupton edhe marrjen e përgjegjësive, ne kemi deleguar aksionaret tanë dhe më tutje nuk dimë se çfarë po ndodh, a ka ndryshime në bord, a ka ndryshime në strukturën udhëheqëse tek kryeshefat ekzekutiv, apo është zgjatur mandati nuk kemi kurrfarë transparence, kjo është papranueshme dhe e frikshme. Andaj lidhur me këto kërkoj një raport të detajuar lidhur me funksionimin e këtyre dy ndërmarrjeve.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-pyeti sa punëtor numëron kompania “Uniteti” në Vushtrri, në çfarë gjendje janë në aspektin fizik-shëndetësor, a ka kontroll sistematik shëndetësor të tyre, për faktin se ata kryejnë një shërbim jo të lehtë. Si qëndrojnë me paga dhe çfarë mekanizim punues posedojnë.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se ai është anëtar i komisionit të aksionareve, dhe asnjëherë nuk është thirrur në ndonjë takim për të shqyrtuar raportin e kësaj kompanie. Mendon se është e rrugës që së pari raporti të shqyrtohet në bordin e Kompanisë, më pas duhet të kaloj në trajtimin nga ana e Komisionit të Aksionarëve, dhe vetëm pas aprovimit nga këto dy instanca të ofrohet para kuvendit komunale për shqyrtim. Andaj ky raport nuk i ka përfillur rregulloret dhe si i tillë fare nuk duhet të shqyrtohet nga kuvendi i komunës.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-tha se në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, formohet komisioni i aksionarëve, ndërsa ky i fundit ka kompetencën që formoj Bordin e Drejtorëve, ndërsa bordi zgjedh zyrtarin e larët dhe kryeshefin ekzekutiv të kompanisë. Ligjërisht bordi ju i jep llogari kuvendit të komunës, por komisionit i aksionarëve që është i emëruar nga kuvendi i komunës. Pra komisionit i aksionarëve ka për obligim të raportoj para kuvendit për të hyrat dhe shpenzimet për strategjinë zhvillimore dhe politika e ndërmarrjes se ky komision nuk është zgjedhur për të shikuar por për të kryer punët që është ngarkuar.

Gazmend Morina, kryeshef ekzekutiv i Kompanisë Uniteti-paraqiti sqarime të përgjithshme duke u përgjigjur në pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Kërkoj nga kryetari i komunës të rritet tarifa e shërbimit për mbeturina nga 4.40 € në 4.90 €.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ngritja e tarifës së mbeturinave nuk mendon se do të ishte ndonjë barrë e rënd për qytetarët. Ndërsa provizioni prej 1.40 €, mendon se edhe ligjërisht është e kontestueshme. Pastaj njoftoi se në kohën e udhëheqjes së komunës nga Kryetari z.Mulaku, kompania “Uniteti” është subvencionuar me nga 10,000.00 € nga komuna për mbulimin e shpenzimeve të derivateve. Pastaj ngriti shqetësimin se punëtorët e kompanisë në fjalë kanë paga shumë të dobëta dhe nuk ju mbulohet racioni i ushqimit ditor. Kërkoj që punëtorëve të operativës që grumbullojnë mbeturinat të iu ofrohet një shujtë racion prej 5 € në ditë.

Sylejman Meholl, anëtar i kuvendit-kërkoi nga strukturat udhëheqëse të kompanisë “Uniteti” të ketë përmirësim të kushteve të punës për punëtorët, mos vonesa në ekzekutimin dhe ngritjen e pagave për ta. Ai falënderoj punëtorët e kësaj kompanie, për punën e madhe që janë duke e bërë

dhe vërtet falë punës së tyre Vushtrria ka ndryshuar substancialisht në aspektin e menaxhimit të mbeturinave dhe ruajtjes së ambientit. Ndërsa komuna duhet ta rritë përkrahjen ndaj kësaj kompanie.

Remzi Ahmeti, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime sa i përket pagave të punëtorëve të Kompanisë “Uniteti”.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-falënderoi strukturat udhëheqëse dhe punëtorët e Kompanisë “Uniteti” për punën e madhe që kanë bërë këto viteve të fund dhe u zotua se bashkëpunime dhe përkrahja e Komunës me kompaninë vetëm sa do të thellohet.

7. Shqyrtimi i kërkesës i Këshillit të Bashkësisë Islame lidhur me rishikimin e memorandumit për shërbime të varrimit;

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-njoftoi se në bazë të vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, ish kryetari i komunës ka lidhur memorandum mirëkuptimi, dhe në këtë rast nuk ka nevojë për një vendim tjetër për ndryshimin e këtyre tarifave, kjo çështje bie në kompetencat e kryetarit të komunës.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se jemi që ky memorandum të vazhdohet por jo njëjtë, për faktin se shërbimi kryesor që lidhet me hapjen e varreve, shërbim i cili nuk është duke u kryer. Andaj si grup kuvendar kërkojnë që në kuadër të këtij memorandum të kthehet shërbimi i hapjes së varrit, nëse një shërbim i tillë nuk ofrohet atëherë nuk kuptim dhe interes komuna ta vazhdoj këtë memorandum. Nëse do të ofrohej ky shërbim, rritja e tarifës së shpenzimeve të varrimit nuk do të paraqiste problem.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se para së të sillje ky memorandum në kuvend dhe para propozimit për rritjen e kësaj tarife, është dashur të konsultohet baza ligjore, për arsye se kjo çështje është e kundërligjshme, sepse kjo duhet të zgjidhet vetëm përmes procedurave të prokurimit nëse do të donim ta respektojmë ligjin, sepse të gjitha pozicionet si: hapja e varrit, dërrasat, qefini, piramidat me mbishkrime dhe transporti janë çështje që të shpallen në tender të hapur përmes konkurrencës, ndërsa pastrimi i kufomës dhe kryerja e ritualeve të varrimit mundet të bëhet prapë përmes procedurave të prokurimit të veçantë përmes negocimit. Andaj kësaj nuk është në kompetencën e kuvend të caktoj vlerën e çmimit dhe as me ngrit atë, në këtë kontekst ndjenë obligim të sqaron se kjo çështje është e kundërligjshme dhe ka qenë edhe në kohën kur është lidhur ky memorandum. Ai nuk preferon një formë të tillë të kontraktimit të këtyre shërbimeve kundërligjore, sepse akoma nuk kemi një raport se sa i kanë kushtuar këto shërbime Bashkësisë Islame, dhe kjo e fundit a i ka paguar ndonjë tatim shtetit e për të cilën nuk beson se kanë kryer. Në fund tha se forma e vetme e ligjshme e kontraktimit të këtyre shërbimeve është përmes procedurave të prokurimit, dhe se nuk i takon kuvendit të marr vendim.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se beson se zyrtarët e prokurimit, e kanë shikuar bazën ligjore për një kërkesë të tillë dhe rrjedhimisht këtë kërkesë e kemi procedura në kuvend për aprovim. Pastaj shtoi se është specifike kërkesa në fjalë sepse nëse shpall tender publik nuk ka operator ekonomik që kryejnë këto shërbime. Në të kundërtën nëse kjo kërkesë është e kundërligjshme as ai vetë nuk e mbështet. Por kontraktimi i këtyre shërbimeve ka qenë vite më parë në këtë formë dhe auditor gjeneral nuk është se ka dhënë vërejtje më parë. Sa i përket shërbimeve të varrimit sidomos hapja e varrit por edhe mirëmbajtja e varrezave është menduar të kaloj në menaxhim në ndërmarrjen “Përparim” e cila është themeluar tash së voni. Kjo është menduar kështu sepse siç dihet Bashkësia Islame nuk mund ta kryej si duhet këtë shërbim për shkak të mungesës së kapaciteteve.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-njoftoi se kuvendin se deri më tash pagesa e shërbimeve të varrimit është bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve që ka qenë formë jo ligjore. Tani e tutje është planifikuar që këto shpenzime të mbulohen nga kategoria e subvencioneve nga të hyrat e bartura që është formë plotësisht ligjore.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit-pyeti kryetarin e komunës si pjesëtarëve të feve tjera jo-islam a iu paguna komuna shpenzimet e varrimit.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se është gatshëm që të gjithë konfesionet fetare që bëjnë kërkesë komuna të iu mbuloj shpenzimet e varrimit komuna është e të gjithëve pa diskriminim.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se nëse është paraparë në statutin e ndërmarrjes “Përparim” që ndër shërbimet që ofron ndërmarrja është edhe hapja e varrezave, atëherë fton dhe kërkon nga komuna që kjo ndërmarrje të fuqizohet me mekanizëm të duhur që kjo ndërmarrje ti kryen shërbimet ashtu si na ka hije dhe të rritet cilësia e shërbimeve që ofron kjo kompani. Lidhur me dokumentacion vlerësoi se vendimi i kuvendit për këto shërbime është marr në vitin 2017 dhe të gjitha memorandumet e mirëkuptimit janë lidhur duke u thirrur në atë vendim, dhe tani nuk ka nevojë për një vendim tjetër të kuvendit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se kjo formë e kontraktimit është kundërligjore, dhe se forma e vetme është përmes procedurave të prokurimit të negociuar, ndryshe edhe nëse voton kuvendi prapë kemi shkelej ligjore sepse vendimet e kundërligjshme nuk ka obligim ti zbatohet kryetari i komunës e askush tjetër.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-tha se vendimi i kuvendit me numër protokollit 189/17 i datë 29.06.2017, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit duhet të shfuqizohet pasi që mjetet në saje të këtij vendimi janë siguruar nga kategoria mallra dhe shërbime gjë e cila bie ndesh me ligjin. Tani duhet të merret vendimi i ri ku mjetet për shërbimet e varrimit mbulohen nga kategoria subvencione dhe transfere. Ndryshimi dhe fshirja e disa neneve në memorandumun e mirëkuptimit pa vendim të kuvendit nga ish-kryetari i komunën përbën shkelej ligjore.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-propozoi që të merret vendimi i kuvendit për rritjen e tarifës, dhe konform këtij vendim të hartohet një tekst i spastruar i memorandumun të mirëkuptimit i cili do të mund të sillet në kuvend për aprovim.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se vendimi i vitit 2017 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, nuk ka precizuar në mënyrë të veçantë shërbimet që do të ofrohen siç janë: hapja e varrit, larja e kufomës dhe shërbime tjera. Sipas mendimit të tij lidhja e memorandumun të dytë ishte në kundërshtim me ligjin dhe me vendimin e kuvendit. Kurse tani është sjellë në kuvend kjo kërkesë e cila është kërkesë e Bashkësisë Islame. Ndërsa sa i përket memorandumun të mirëkuptimit ai do të sillet në kuvend në mbledhjen e radhës pasi ai duhet të renvohet pas skadimit të afatit. Ndryshimi i memorandumun të mirëkuptimit nuk mund të bëhet pa vendim të kuvendit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se nëse ka ardhur koha për lidhjen e një memorandumun të ri me Bashkësinë Islame atëherë le të lidhet ky memorandum në saje të kushteve të reja financiare dhe ligjore dhe më pas dërgojeni në kuvend ku të gjethe do ta përkrahim aprovimin e tij. Ndërsa kërkoj me patjetër që pjesë e këtij memorandumun duhet të jetë edhe shërbimi i hapjes së varrit. Në qoftë se Bashkësia Islame nuk mund të ofroj këtë shërbim atëherë të gjendet një modalitet tjetër që të subvencionohen familjet që kanë rast vdekje me nga 100 € ndihmë ku do ta mbuloni shpenzimin e këtij shërbimi.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-tha se duke parë si mjaft të rëndësishme ofrimin e shërbimeve të varrimit, duhet të gjithë ta përkrahim rritjen e kësaj tarife dhe deklaroi se grupi kuvendar i PDK-së e mbështet këtë propozim.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-vlerësoi se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet dhe pasi të nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit duhet të silltet në kuvend për aprovim.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 16 vota “për” 6 vota “kundër” dhe 4 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim rritet vlera e tarifës për shërbimet e varrimit, në shpenzimet komunale për ritet fetare që ofrohen nga Bashkësia Islame Dega në Vushtrri, nga 180 € sa është aktualisht në 200 €.

2. Rritja prej njëzet (20 €) e vlerës së kësaj tarifës bëhet si rezultat i rëndimit të gjendjes së përgjithshme ekonomike, në kushtet e ngritjes së çmimeve dhe shtrenjtimit të kostos së jetesës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për lirim nga pagesa e taksës komunale për kiosqet nga druri;

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-pyeti se a janë të inkorporuar të gjitha kiosqet e drurit në lirim nga kjo ngarkesë komune, nëse janë atëherë do ta përkrahin këtë propozim-vendim.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-pyeti se komisioni i cili ka dhënë në shfrytëzim këto shtëpiza të drurit, a janë duke u shfrytëzua të njëjtat sipas destnimit, për faktin se ka shumë biznese tjera të cilat do të kishin operuar në këto prona komunale, andaj komisioni duhet ta bëjë një rishqyrtim se kujt ia ka dhënë në shfrytëzim këto shtëpiza të drurit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me 31 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, kioskat nga druri që jepen në shfrytëzim nga komuna për më pak se një vit, nga data 1.5.2022 deri më 25.4.2023.

2. Qëllim i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive, të cilat operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria e Inspektimeve.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-deklaroi se në formën si është sjell ky propozim-vendim ai nuk do ta votojë. Tutje shtoi e kur është aprovuar buxheti i komunës, është votuar me mendimin se mjetet

vetanke do të shfrytëzohen në kuptimin e përmbushjes së aktiviteteve të parapara, edhe pse ka pasur pozicione, që sikur të ishte planifikuar buxheti me kohë dhe të ishim në afatet ligjore do të kishim tjera rezultate. Mirëpo pasi ishim në dijeni për bartjen e të hyrave komunale atëherë e kemi përkrah dhe e kemi konceptuar drejtë votimin e buxhetit, duke menduar se me të hyrat vetnake do ti japim një frymë ndryshe buxhetit, duke i dhënë fuqi edhe për zhvillim ekonomik edhe për mbulimin e nevojave qytetare në aspektin konsumues por edhe në atë social. Qeveri komunale zotëri Kryetar i komunës ju informoj se në Komunën e Vushtrrisë jetojnë rreth 1500 familje me asistencë sociale, këto familje luftojnë për ekzistencën e tyre, të tjera që nuk gëzojnë asistencë sociale rrezikohen nga skamja ekstreme, të pa punët janë në gjendje të renduar, të sëmuret sidomos me sëmundje kronike vuajnë për barna dhe trajtim me dinjitet shëndetësor. Personat me aftësi të kufizuar pothuajse i janë lanë fatit nuk sheh dhe nuk ka politika stimuluese për biznese e me këtë edhe hapja e vendeve të reja të punës si koncept dhe si kategori nuk ekziston fare. Të gjitha këto të cekura është dashur të jenë impakt në buxhet në bartjen e mjeteve por edhe në zhvillimin ekonomik të komunës. Paraprakisht kërkoj të dinë se sa është vlera e obligimeve kontraktuale të bartura nga viti 2021 në vitin 2022 dhe se ka qeveria komunale mjetet të parapara për financimin e këtyre projekteve. Pastaj sa është kostoja apo vlera e vendimeve të kuvendit të komunës që nuk janë realizuar deri më tani, sepse ka vendim nga viti në vit dhe ende nuk janë realizuar. Ndër këto vendim është ai për përkrahjen e klubeve sportive dhe shoqatave tjera në vlerë 200,000.00 €, pastaj një tjetër vendim me peshë fundamentale është ai i kompensimit të familjeve me viktimat nga covid-19, por edhe atyre që janë prekur nga kjo pandemi, ky vendim me rëndësi duhet të jetësohet sa më shpejt. Sa janë obligimet e bartura në subvencionet në bujqësi, sepse jemi në dijen se para disa muajve bujqit kanë paguar participim për mjetet në bujqësi pajisjes bujqësore të parapara me buxhet dhe ende nuk i kanë marr këto mjete. Sa është vlera e detyrimeve kontingjente dhe a rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të komunës. Të gjitha këto të cekura do duhej të ishin të raportuara këtu në kuvend dhe konform obligimeve, do të duhej të planifikohej bartja e më këtë edhe shpërndarja buxhetore, sepse në formën e propozuar rrezikojmë që një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të shpenzohet duke mbuluar obligime përmbartimore dhe taksa gjyqësore. Kjo është kështu sepse akteret që janë të prekur me këto vendim do të mund të inicionin procese gjyqësore për realizimin e drejtave të tyre që burojnë nga këto vendim. Në fund deklaroi se këto pika nuk do ti votoj dhe të njëjtat do ti dërgoj për shqyrtim në MAPL për vlerësim sepse të njëjta nuk i kanë kaluar fazat ligjore.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se vitin e kaluar PDK në Vushtrri, nuk e kishte aprovuar buxhetin e komunës për arsye puro politike, ndërsa në subjekt politik, muaj më parë në mënyrë unanime e votuam buxhetin vetëm për mos ta bllokuar komunën. Sa i përket këtyre dy pikave që tani po trajtohen në lidhur me këtë mbajtëm një seancë të jashtëzakonshme, ku materiale nuk ishin të përgatitura mirë dhe ishin jo profesionale. Por sot jemi në një situatë tjetër që këto pika janë sjellë e që prapë kanë të meta por me qëllim të mos bllokimit grupi i LDK-së do ti votoj dhe të njëjtat do të vlerëson në kuptimin ligjor nga MAPL-ja.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se nuk është respektuar normativi ligjor sa i përket këtyre dy pikave për bartjen dhe tejkalimin e të hyrave komunale, sepse të njëjtat nuk kanë kaluar në filtrin ligjor të KPF-së e që është detyrë ligjore që dokumentet dhe politikat financiare të shqyrtohen nga Komitetit për Politikë dhe Financa. Ai kërkoi një arsyetim dhe analizë vizionare nga kryetari i komunës dhe drejtori i drejtorisë gjegjëse se përse duhet votuar këto pika. Në këtë rrafsh pyeti, a pasqyrohen në këtë bartje të mjeteve disa vendim të kuvendit të cilat më herët nuk janë zbatuar një nga ato vendim është ai që lidhet me subvencionimin e klube sportive dhe shoqatave që më herët veç u përmend, më tej disa vendim tjera për ndërtimin e urave dhe rrugëve,

një prej tyre që është e dëmtuar është ura e fshatit Akrashticë dhe ky projekt a është i pasqyruar në këto bartej të mjeteve. A është planifikuar subvencionimi me këtë bartej të prekurit nga covid-19. Kodi ekonomik 46840 është interesant ky kod që parasheh renovimin e stadiumit <Musa Abazi>, në njërin anë planifikojmë renovimin e këtij tregu e në anë tjetër në një pjesë të tij propozoni vendosjen e tregut këto projekte në këtë formë nuk kanë logjik dhe nuk plotësojnë interesin e përgjithshëm.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-në arsyetimin e këtyre propozim-vendimeve për bartej dhe tejkalim të hyrave komunale shtoi se impakti do të jetë tek të papunët, tek nxënësit studentët dhe tek kategoritë tjera. Ky është buxheti më i madhe që është subvencionuar ndonjëherë në vlerë prej 1,297.540.00 €, që dallimi është në vlerë prej 37000, 235.007 € më shumë se sa vitin e kaluar. Në këtë kontekst arsyetoi se në kuadër të bartjes janë planifikuar subvencione në bujqësi, për herë të parë subvencionohet ujitja e tokave në 50 % , pastaj përkrahja e fermerëve për 4 cent për litër të qumështit, ky subvencionim do të jetë tërësisht transparent. Pastaj do të ndihmohen bletarët, janë rritur bursat për studentë, do të ndihmohen 400 të ri dhe të reja në aftësim profesional. Është vazhduar subvencionimi i lehonave që ka qenë në fuqi edhe në mandatet e kaluara. Jemi hi në një marrëveshje bashkëpunim me shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e 10 shtëpive dhe kjo do të jetë një ndihmesë, mbulohen qiratë për skamnorët për banim. Të gjitha këto dhe të tjera që nuk u përmend janë instrument që janë futur në këtë bartej që do të ndikojnë në shumë dimensione për përmasimin e gjendje ekonomike e sociale, andaj kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës aprovohet nga ana e kuvendit. Pastaj të gjitha projekte kapitale që kanë mbetur nga mandati i kaluar do të vazhdohen sidomos ato projekte që janë dy dhe tri vjeçare.

Remzi Ahmeti, drejtor i DBF-së-s qarroi se obligimet nga të hyrat e bartura të tejkaluar janë 1,215,675.47 €, ndërsa subvencionet janë 37000, 235.007 € të cilat janë të orientuara kryesisht në bujqësi dhe kulturë por edhe në dimensione tjera.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-kërkoi të jepen sqarime nga Drejtori për Buxhet dhe Financa, lidhur me subvencionet në Drejtorinë për Administratë.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-tha se ndodhemi para dy krizave të rënda njëra është ajo me pandeminë covid-19, ndërsa tjetra kriza e madhe ekonomike që e ka përfshirë globin. Andaj si rezultat i këtyre komuna është dashur të jetë e involvuar në mënyrë më direkte me hapa konkret për çdo kategori. Në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi që të ndahen 50,000.00 € për të shpërndarë pako ushqimore për familjet në nevojë, të ndahen 100,000.00 € subvencion për bizneset ekzistuese për ti mbuluar kamatat e kredive, të ndahen 50,000.00 € mbështetjesh për të vetë punësuarit dhe 100,000.00 € grantet për rini dhe bizneset ekzistuese dhe zgjerimin e tyre. Kriza e tillë ekonomik trajtohet përmes mbështetjes së tillë direkte. Shuma totale e këtyre propozimeve është përafërsisht 300,000.00 € dhe nuk është ndonjë shumë aq e madhe që do ndikonte direkt në buxhetin e komunës në kategoritë e mjeteve të bartur. Në fund ceku se nëse propozimet e tij përfillen atëherë ai do ta përkrah këtë propozim-vendim.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se propozimet e parafolësit janë të mira, por ato nuk ka mjete për ti mbështetur. Pastaj shtoi se orientimi i subvencioneve në fushën e bujqësisë është bërë me qëllim të shpëtimit nga falimentimi i bujqve.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-tha se me shumën që ai e propozoi do të mund të hapeshin rreth 100 vende të reja pune dhe kjo do të ishte tepër pozitive. Ajo çfarë ai vlerëson është fakti se ndarja e një fondi emergjent për të ndikuar direkt tek shtresat sociale do të jetë e paevitueshme, dhe kjo nuk ka alternativ, por sa më herët të bëhet kjo aq më mirë do të jetë për qytetarë e Komunës së Vushtrrisë, kjo është kështu sepse kjo është veç fillimi i ballafaqimit me krizën ekonomike.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 24 vota “për” 3 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2021 në kategoritë ekonomike të cekura si më poshtë:

1.1 Mallra dhe shërbime	306,354.13 €
1.2 Shpenzime komunale.....	9,994.73 €
1.3 Subvencione dhe transfere.....	593,966.26 €
1.4 Investime kapitale.....	227,973.92 €

Totali i mjeteve të tejkaluara.....1,138,289.04 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pyeti drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe atë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim se cili do të jetë impakti ekonomik i bartjes së të hyrave komunale në dikasteret që ata i përfaqësojnë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me 25 vota “për” 8 vota “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në kategoritë si në vijim:

1.1 Mallra dhe shërbime.....	675,131.31 €
1.2 Shpenzime komunale.....	14,504.93 €
1.3 Subvencione dhe transfere.....	693,700.00 €
1.4 Investime kapitale.....	1,190,675.47 €

Totali i mjeteve të bartura.....2,574,011.71 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtri;

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se edhe atëherë kur është votuar ky lokacion për vendosjen e tregut kishte tërhequr vërejtjen se ky lokacion ka qenë i gabuar, sepse i njëjti nuk i përmbush kushtet për shitësit që do të vendosen atje. Tani ky propozimi i ri tek paraku do të përkrahet nga grupi i tij politik duke shpresuar se i njëjti lokacion nuk do të ndërrohet në seancën e kuvendit. Lokacioni i caktuar në kohën e më hershme ka qenë i duhur por i njëjti është zhvendosur për arsye politike, por me qëllim të mos bllokimit të komunës ata do ta votojnë këtë propozim.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se qysh herët në mandatin e kaluar ka pasur premtime për këtë projektin ndërtimi i tregut si model i Tiranës, por ai asnjëherë nuk është realizuar, vetëm si e ndërrohej struktura e projektit. Dallimi i qeverisë aktuale është se ajo është vetëm duke i ndërruar lokacionet e këtij tregu herë një vend e në seancën tjetër në një vend tjetër. Ajo që është interes i përgjithshëm është që ky lokacion është të mbetet në vendi këtu tek taksitë në qendër të qytetit aty ku është marr vendimi që e ka përkrahur edhe grupi i tyre politikë dhe kërkoj që ky vendim të zbatohet. Në emër të grupit kërkoj që kjo pikë të shtyhet dhe të mbetet lokacioni aktual i caktuar.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit-tha se nuk jemi të sigurt nëse shitësit që janë duke shitur këtu afër marketit viva fresh, që do të shkojnë në atë treg. Pastaj shtoi se lokacioni i propozuar tek stadiumi “Musa Abazi” është lokacioni i vetëm që i mbetur në qytet që komuna do të mund ta ndërtonte një çerdhe në të ardhmen. Në lokacionin e caktuar afër çerdes po flitet se do të kemi ndërtime të larta, dhe nëse kjo ndodhe është e dëmshme dhe e papranueshme.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se komuna ka mungesë të hapësirave për lokacione për ndërtimin dhe ngritjen e aseteve për interes të përgjithshëm. Caktimi i lokacionit tek stadiumi është menduar se do të jetë adekuat, dhe për këtë është marr edhe mendimi i arkitektëve. Ajo që flitet për ndërtime të larta tek taksitë, nuk është aspak e vërtet dhe shtoj se nuk e ka ndërmend të merret për siç tha me “fjalët e kafeve të Vushtrrisë”. Lokacioni i caktuar për treg është caktuar në interes të përgjithshëm dhe mendojmë se është adekuat andaj ftoj qo i njëjti të përkrahet.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se lokacioni i propozuar për treg nga ana e qeverisë komunale nuk i plotëson kushtet, pasi bëhet fjalë për një sipërfaqe tepër të vogël.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me 25 vota “për” 8 vota “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtri, në parcelat kadastrale: P-70202016-00504-0; 00505-0 dhe 00520-0, në sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 2400 m², Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

4. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi Nr.54/22 i datës 24.2.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, si dhe vendimi i kuvendit të komunës për plotësimin dhe harmonizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri me numër të protokollit Nr.01-80/22 i datës 31.03.2022.

5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni kuvendar për verifikimin e procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, identifikimin e pronave që janë të uzurpuara, si dhe verifikimi i shfrytëzimit të parcelave private ku janë ndërtuar objektet ndërtimore- banesore -kolektive dhe objektet tjera në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën kohore 1999-2022, në përbërjen si në vijim:

- 1.1 Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit (PDK);
- 1.2 Agron Përçuku, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.3 Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.4 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit (LVV) dhe
- 1.5 Bekim Zabërgja anëtar i kuvendit Nisma Socialdemokrate.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi në takimin e parë, në përbërjen e tij duhet të zgjedhë kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, dhe pas verifikimit të këtij procesi duhet të hartojë raport me shkrim lidhur me të gjeturat në terren dhe të njëjtin duhet të t’ia adresojë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora: 14:40.

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

Për: Për KPF dhe Kuvendin e Komunës

Propozues: Kryetari i Komunës, z. Ferit Idrizi

Hartues: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Medina Bunjaku

Lënda: Propozim-vendim

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, shkronja "d" në lidhje me nenin 40, paragrafi 2, shkronja "h" të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 40, paragrafi 2, shkronja "gj" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, nenit 2 paragrafi 2, në lidhje me nenin 19 të Rregullores për Dhënie e Dekorativë, 01 Nr. 209/20 e datës 29.10.2020, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2022, mori këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MIRËNJOHJEVE PËR NDER TË 17 QERSHORIT - DITËS SË ÇLIRIMIT

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës, për nder të Ditës së Çlirimit, më 17 qershor ndan këto mirënjohje:
 - 1.1. Aziz Krasniqi – veteran i luftës. Propozuar nga OVL e UÇK-së, dega në Vushtri.
 - 1.2. Zenë Zahiti – veteran i luftës. Propozim nga SHIL e UÇK-së, dega në Vushtri.
 - 1.3. Isa Zeka – veteran i luftës. Propozim nga Shoqata "Martirët e Lirisë".
 - 1.4. Tahir Krasniqi – i burgosur politik. Propozim nga SHBP.
 - 1.5. Hamit Zuçaku – (pas vdekjes) propozim nga ana e SHFD të UÇK-së.
 - 1.6. Ali Jakupi – (pas vdekjes) ish – ministër, profesor universitar. Propozim nga ana e Komisionit.
 - 1.7. Habib Mustafa – veteran i luftës dhe i arsimit, profesor i historisë. Propozim nga Komisioni.
 - 1.8. Elvira Mazhiqi – artiste në solo-këndim. Propozim nga ana e Komisionit.

Melihate Basholli

Kryesuese e Kuvendit

ARSYETIM

Bazuar në pikën 3 të nenit 19 të Rregullores për Dhënie e Dekoratave, nr. 209/20 e datës 29.10.2020, e miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrisë dhe pikën 3 të Vendimit për Formim të Komisionit për Dekorata, i nxjerrë nga Kryetari i Komunës, Komisioni për Dekorata në katër takimet e mbajtura në lidhje me propozimet dhe shqyrtimin e propozimeve të emrave që janë propozuar, si dhe duke u bazuar në listën e emrave të personaliteteve që janë nderuar prej pasluftës e deri në vitin 2021, ka vlerësuar se emrat e propozuar meritojnë nderim nga ana e Kuvendit të Komunës.

Gjithnjë duhet marrë parasysh se lista e njerëzve meritorë që duhet të nderohen është e gjatë, por që këta njerëz që janë propozuar kanë dhënë kontribut të çmueshëm për vendin, në profesionet e tyre, andaj kemi vlerësuar se kjo listë do të gjejë mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit Komunal, gjithnjë duke lënë hapësirë dhe mundësi edhe për dy emra të rinj që mund të propozohen nga anëtarët e Kuvendit Komunal të Vushtrisë.

Bashkëngjitur me këtë propozim vendim gjeni edhe biografite e të gjithë të propozuarve.

Medina Bunjaku
Drejtoreshë e DKRS-së





ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



Dega në Vushtrri

Për:Kuvendin komunal Vushtrri

Lënda:Propozim

Dega e OVL të UÇK së në Vushtrri me rastin e shënimit të ditës së
Çlirimit të Komunës tonë për Mirënjohje

Propozon Veteranin z.AZIZ FAIK KRASNIQI

AZIZ KRASNIQI lindi më datë 31.03.1973 në fshatin ZHILIVOD .
Shkollën fillore e kreu në vendë lindje të mesmën në Vushtrri, ishte aktiv në
të gjitha proceset që ndodheshin asokohe në vendin tonë.

Në fillimin e luftës i iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të
Kosovës.

U radhitë në Zonën Operative të SHALËS në brigadën 142 në batalionin e
parë, ku dha një kontribut të jashtëzakonshëm për Çlirimin e vendit tonë.

Ishte prezentë në të gjitha betejat që u zhvilluan në kuadër të batalionit të
parë të brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës,

VUSHTRRI



Biografia për z. Zenë Zaiti

Zenë Zaiti u lind më 04.04.1970, në fshatin Kçiq të Mitrovicës. Ishte ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga 09.06.1998 në Njësinë Speciale të Zonës Operative të Shalës. Ai u plagos në luftimet mes ushtarëve të UÇK-së dhe forcave serbe në Ashlan, më datë 30.05.1999.

Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së propozon z. Zenë Zaiti që të nderohet me mirënjohje, me rastin e Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17.06.2022.

"MARTIRËT E LIRISË"



SHOQATA „MARTIRËT E LIRISË 98/99” VUSHTRRI

Adresa: Wesley Clark –Email: martiret-1999@hotmail.com

Tel.028/573/664, 044/847/160

Shoqata e martirëve “Martirët e lirisë98/99 ” I propozon Komunës së Vushtrrisë që Isa Zeka në cilësinë e familjarit rrespektivisht vëllait të Martirëve Nexhmedin Zeka,Agim Zeka dhe Naser Zeka t’i ndahet Mirënjohje.

Isa Zeka është vëllau i Nexhmedin,Naser e Agim Zekes .

Tani më dihet se më 22.05.1999 ditën e kobshme për Vushtrrin forcat policore, ushtarake e paramilitare serbe si shumë familje dhe familjen e Isa(Arif)Zekes e dëbuan nga shtëpia.Duke I dërgua ne drejtim të varrezave të qytetit paramilitar, policë e ushtar serb I ndan nga familja Nxhmedin,Naser e Agim Zeken. Dihet se I dërguan në drejtim të shtëpisë të Kahriman Pasomës.

Nexhmedin(Arif)Zeka ishte I lindur më 12.06.1977 në Vërnice konsiderohej I zhdukur deri më datë 16.09.2005 kur u bë rivarrimi I ti në varreza të martirëve në qytetin e Vushtrrisë.

Naser(Arif)Zeka ishte I lindur më 01.09.1975 në Vërnice konsiderohej I zhdukur deri më datë 22.05.2012 kur u bë rivarrimi I ti në varreza të martirëve në qytetin e Vushtrrisë .

Agim (Arif) Zeka ishte I lindur më 25.10.1979 në Vërnice konsiderohej I zhdukur deri më date 22.05.2012 kur u bë rivarrimi I ti në varreza të martirëve në qytetin e Vushtrrisë.

Ju faleminderit për miëkuptim



Biografia për z. Tahir Krasniqi

Tahir Krasniqi u lind më 24.08.1955, në Breznicë. I burgosur politik në vitin 1981. Aktivist i Çështjes kombëtare në vazhdimësi. Pjestar i luftës në Zonën Operative të Drenicës, Brigada 114 Fehmi Lladrovci, Batalioni i III, Kompania e III. Shtëpia e tij ishte shfrytëzuar si shkollë në kohën kur u mbyllën shkollat shqipe. Aktualisht është kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politikë, në Vushtrri.

Shoqata e të Burgosurve Politikë e propozon z. Tahir Krasniqi që të nderohet me mirënjohje, me rastin e Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17.06.2022.

Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së
USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS
Rr: Wesley Clark,
Vushtrri, Kosovë
Nr. Tel 044/876/750



Association of Families War Martyrs of
KOSOVA LIBERATION ARMY
St: Wesley Clark
Vushtrri, Kosovë
049/329/399

Për: Drejtorin e DKRS të KK të Vushtrrisë Znj.M.Bunjaku

Propozimet për ditën e Çlirimit të Vushtrrisë 17 Qershori.

Nga : Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve dega –Vushtrri

Lënda: Kërkesë

Data: 29.04/2022

E nderuara Drejtoresh Znj.M.Bunjaku ,ne si Shoqatë e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-ës-Vushtrri e propozojmë për mirënjohje,për ditën e Çlirimit të Vushtrrisë 17 Qershori

1. Baben e Dëshmorit të UÇK-së Blerim Zuçaku bacin Hamit (Halit) Zuçaku (Postmortum) e cila ndahet për ditën e Çlirimit të Komunës sonë Vushtrrië 17 Qershori.

Hamit (Halit) Zuçaku I lindur me 05\05\1916 ne Doberlluk të Vushtrris Xhandarë I Policisë Shqiptare në Vushtrri qat vitit 1940,Ushtar I Shaban Polluzhës I denuar me burgim të përjetshum ,për aktivitetet e luftës Kombëtare si Ushtar I Shaban Polluzhës dhe pas shpartallimit të Brigadës ,deturohet të qëndrojë, tri vite në arati kapet dhe pargoset për dy vite në burgun e Vushtrrisë dhe me amnisti lirohet.

Bab I Heroit të Kosovës Dëshmorë I Kombit të UÇK-së ZOSH 142

Blerim H.Zuçaku I rën te bankinat në lumin Silnica Vushtrri në datën 22\05\1999

2.Baben e Dëshmorit të UÇK-së Jeton Tërstena bacin Avdyl (Ali) Tërstena (Postmortum) e cila ndahet për ditën e Çlirimit të Komunës sonë Vushtrrisë 17 Qershori.

Avdyl (Ali) Tërstena I lindur me 21\04\1942 në Vushtrri , bab I Heroit të Kosovës Jeton Tërstena I rën në Pantin në datën 06\08\1998.

Shpresoj se propozimi yn nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve do të miret parasyshtë sepse ne si shoqëri ja u kemi borgj Dëshmorëve të përkujdesemi për familjet e tyre.

Mbesim me shpresë që kërkesa jonë do të përkrahet!

Vushtrri 29/04/2022

Kryetari I SH.F.D.- VUSHTRRI

Gëzim Zuçaku



Biografi për z. ALI JAKUPI



Ali Jakupi u lind më 26.06.1943, në Shalë të Vushtrrisë. Shkollën fillore e përfundoi në Vushtrri, ku e kaloi një pjesë të fëmijërisë dhe rinisë. Shkollën e Mesme Normale, e kreu në Mitrovicë ndërsa Fakultetin Ekonomik në Prishtinë. Studimet pasuniversitare dhe magjistraturën (nga lëmia e Marketingut) i kreu në Zagreb, në vitin 1973, në temën "*Roli i propagandës ekonomike si funksion marketingu dhe vështrimi kritik në përdorimin në Kosovë.*" ndërsa doktoroi në Fakultetin Ekonomik të Universitetin e Prishtinës, në temën "*Finalizimi - dimensionimi i strategjisë së zhvillimit të ekonomisë së Kosovës.*"

Dr. Ali Jakupi ishte drejtor i përgjithshëm në Ndërmarrjen "Kosova" dhe "Polet", të Vushtrrisë, njëherit ishte edhe drejtor i Tregtisë, zëvendës drejtor i përgjithshëm dhe drejtor i përgjithshëm në Ndërmarrjen "Rilindja", Ministër i Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Parë të Kosovës, profesor në Universitetin e Tetovës, profesor në Universitetin AAB, si dhe në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, për lëndët e Marketingut.

Ali Jakupi me shkrime ka filluar të merret që nga fëmijëria, kur si nxënës filloi të botonte poezitë e tij të para, në revista të ndryshme në gjuhën shqipe. Më vonë filloi të shkruante edhe në prozë si dhe të merret edhe me publicistikë. Është autor i mbi 50 punimeve shkencore e profesionale, të botuara madje edhe jashtë vendit. Nga krijimtaria e gjithmbarshme e tij duhet veçuar:

- *Ekonomia dhe organizimi i ndërmarrjes (tekst mësimor për kl.I-IV të shkollës së mesme ekonomike),*
- *Bazat e ekonomikës së tregtisë,*
- *Bazat e marketingut,*
- *Edukata qytetare (koautor),*
- *Zgjimi i fjalës (poezi),*
- *Hapësirë rrethore (poezi),*
- *Nyjëzim (poezi),*
- *Vrapime në rrathë (roman),*
- *Dy shtete shqiptare dhe bashkimi kombëtar - (publicistikë 1995),*
- *Two Albanian states and national unification (1997),*
- *Për ata Kosova është ëndërr (udhëpërshkrime), etj.*

Ndërroi jetë në vitin 2013

Biografia për z. Habib Mustafa

Habib Mustafa u lind më 23.03.1952 në Stroc të Vushtrrisë. Shkollimin fillor e përfundoi në Gllavatin. Shkollën e Mesme Normale e përfundoi në Mitrovicë, ndërsa fakultetin e Historisë në Universitetin e Prishtinës.

Nga viti 1973 punoi si mësues në Shkollën Fillore "Liria" në Stroc, ku për një periudhë ishte edhe drejtor i kësaj shkolle. Vlen të përmendet se gjatë periudhës sa ishte drejtor në vitet 1990-1995 u ftua shumë herë në biseda informative nga policia serbe në Prelluzhë dhe Vushtrri dhe ishte rrahur e maltretuar fizikisht në prani të nxënësve dhe arsimtarëve dhe ishte burgosur për 2 muaj me vendim të Gjykatave serbe.

Ishte aktivist i dalluar i LDK-së që nga themelimi, dhe anëtar i Kuvendit të LDK-së në Vushtrri

Kontribuoi në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si ushtar i UÇK-së nga prilli i vitit 1998 deri në përfundim të luftës në Zonën Operative të Shalës, përkatësisht në Batalionin e parë të Brigadës 142.

Në shtator të vitit 2004 u zgjodh drejtor i Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina", në Vushtrri.

Tri mandate shërbeu si asamblist i Kuvendit Komunal në Vushtrri, në njërin mandat ishte edhe Kryesues i Kuvendit Komunal.

Ishte sekretar i degës së OVL të UÇK-së për dy mandate

Është autor i dy librave.

Komisioni e propozon z. Habib Mustafa që të nderohet me mirënjohje, me rastin e Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17.06.2022.

Biografia e znj. Elvira Mazhiqi



Elvira Mazhiqi që në moshë të re është interesuar për muzikën. Në moshën 10-vjeçare ndoqi shkollën fillore të muzikës "Tefta Tashko"-Vushtrri si klarinetiste. Që nga ajo moshë ishte pjesë e shumë koncerteve shkollore dhe komunale. Si dhe pjesë e shumë festivaleve ku ajo u vlerësua me çmime të para. Shkollën fillore e kreu në të njëjtën kohë me shkollën fillore të muzikës në Vushtrri. Më pas shkollimin e mesëm për muzikë e vazhdoi në SH.M.M "Prenk Jakova" – Prishtinë, ku u pranua për kanto si lëndë kryesore. Mësimet e kantos i mori nga profesoresha Lindita Hakaj. Në vitin 2018 ajo ishte pjesë e Akademisë Evropiane të Muzikës Verore ku u takua me Caroline Isabel Merz që ishte një motivim dhe ndikim i madh për të për të vazhduar rrugën e saj drejt këndimit operistik. Në vitin 2020 u pranua në Universitetin e arteve të bukura "Hasan Prishtina" në degën e Artit Muzikor drejtimi Solo-këndim tek Prof. Merita Juniku. Po ashtu gjatë këtyre viteve ka mbajtur koncerte edhe jashtë vendit si në Belgjik, Kroaci, Gjermani etj. Koncerte dhe konkurse: 2014-2017 Koncerte në Vushtrri/Kosovë gjatë studimeve në Shkollën Fillore të Muzikës "Tefta Tashko" 19.04.2016 – Fitues i çmimit të parë në Konkursin e Këndimit "Përmes këngës" 31.05.2017- Pjesëmarrje në festivalin "El Maestro" 2017-2018 Koncerte në Prishtinë/Kosovë gjatë studimeve në Shkollën e Mesme të Muzikës "Prenk Jakova" 11.03.2018-Pjesëmarrës në konkursin e muzikës klasike "Virtuozet" nën drejtimin e sopranos Inva Mula 27.03.2018-"Kengetarja me e mir"-Flakadani i Karadakut 10.05.2018-Fitues i çmimit të tretë në Konkursin e Këndimit "Pjeter Gaci" në Shqipëri 30.08.2018-Koncerti "Opera Night" i "European Summer Music Academy"- ESMA në Kosovë 25.10.2018- Fitues i çmimit të parë në konkursin e këndimit "Pianisti i Ri" në Tetovë. 27.03.2019-"Kengetarja me e mir"-Flakadani i Karadakut 26.04.2019- Koncert me rastin e binjakëzimit të shkollës "Prenk Jakova" Prishtinë dhe "Aydın Doğan" Stamboll. 23.05.2019- Koncert për 70 vjetorin e themelimit të shkollës "Prenk Jakova". 2.06.2019-Fitues i çmimit të tretë në Konkursin Ndërkombëtar të Muzikantit të Ri "Ars Kosova" në Kosovë. 31.07.2019-"Opera Night"Finale e Parë e Le Nozze di Figaro (Akti 2) 22.12.2019-Pjesëmarrje në korin e vajzave e shoqëruar nga Filarmonia e Kosovës nën drejtimin e Noorman Widjaja 6.10.2020- Pjesëmarrje në skenën e re në "Prishtina International Vocal Festival" 6.12.2020-"Solistja më e mirë" Në konak të Rahovecit na bashkon kënga shqipe 29.07-07.08.2021-Rame Lahaj International Opera Festival 31.07.2021-Koncerti i inaugurimit të Operës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Komisioni për Dekorata

DATË/A	25 maj 2022
REFERNCË/A	34/03
PËR/ZATO	Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Sekretarisë së Kuvendit
NGA/OD/FROM:	Kryesuese e Komisionit për Dekorata Znj. Medina Bunjaku 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	APROVIM I PROPOZIMEVE PËR DEKORATA

Në bazë të nenit 19, pika 3, të Rregullores (KKV) 08/2020 për Dhënie e Dekoratave të datës 29.10.2020 Komisioni për Dhënie e Dekoratave ka pranuar propozimet e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi, në bazë të shkrësës nr. 6421/22 të datës 23.05.2022, në të cilën shkrësë gjenden emrat e të propozuarve për Titujt: "Qytetar Nderi" dhe "Nderi i Qytetit" si dhe Çmimet: "Emblema e Vushtrrisë" dhe "Hasan Prishtina".

Komisioni ka shqyrtuar emrat e të propozuarve dhe ka vlerësuar se personalitetet e propozuara për këta tituj dhe këto çmime janë personalitete që meritojnë nderim institucional, dhe ne si komision mbështesim propozimet e kryetarit të Komunës.

Andaj, Bazuar në nenin 19, të Rregullores për Dhënie të Dekoratave i propozojmë Kuvendit të Komunës që t'i miratoj këto propozim vendime si në dispozitiv.

Shtojcë: Propozim vendimet

Iu dërgohet:

- 1 x Kryetarit të Komunës
- 1 x Arkivit të DKRS-së

REPUBLIKA E KOSOVËS
6421/22
23.05.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel. 038/200 43403, E-mail: ferit.idrizi@rka-gov.net

PËR/ZA/TO: Komisionin për Dekorata
/nj. Medina Bunjaku, Kryesuese e Komisionit

CC

PËRMES/PREKO/THROUGH
NGA/OD/FROM: Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: Propozim për ndarje të Dekoratave



Të nderuar/a,

Gjeni të bashkëngjitur propozim vendimet për ndarje të dekoratave me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit me datën 17 qershor 2022, si në vijim:

1. Titulli "Qytetar Nderi" - dy dekorata
2. Titulli "Nderi i Qytetit" - një dekoratë
3. Çmimi "Emblema e Vushtrisë" - një dekoratë
4. Çmimi "Hasan Prishtina" - tri dekorata

Propozimet për dekorata janë të bazuara në nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për dhënie të Dekoratave Nr. 209/20, dt. 29.10.2020.

Kërkoj që këto propozime, të shqyrtohen nga komisioni për dekorata dhe procedohen për shqyrtim dhe aprovim, konform nenit 19 të Rregullores për Dhënie të Dekoratave, si material shtesë i pikës nr. 3 të rendit të ditës të mbledhjes së Kuvendit të komunës që do të mbahet me datën 26.05.2022.

Me respekt!

Gjendur 23.05.2022, 17:49



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës El Hadumir
Përtues: Zyra e Kryetarit [Signature]
Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 41 pika 41.2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës si dhe nenin 6 të Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënie të Dekorativë prot. nr. 209/20 datë 29.10.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2022 merri këtë:

V E N D I M PËR NDARJE TË DEKORATËS "NDERI I QYTETIT"

1. Me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, z. Muharrem Shabani nga Vushtrria i ipet titulli "Nderi i Qytetit".
2. Dekoraten nga pika 1 (një) e këtij vendimi e dorëzon Kryetari i Komunës në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli – Latifi
Kryesuese e Kuvendit

Sipas Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënie e Dekoratave prot nr. 209/20 datë 29.10.2020, citojmë: titulli "Nderi i Qytetit" i ipet personaliteteve të shquara të Komunës së Vushtrrisë të cilët kanë dhënë kontribute të dalluara, që kanë lartësuar emrin e qytetit dhe kanë një veprimtari të gjerë e të rëndësishme në dobi të qytetarëve, vlera të veçanta e të njohura në rrafshin kombëtar dhe që janë personalitete të rëndësishme në fusha të ndryshme të shoqërisë. Ky titull iu ipet gjithashtu personaliteteve që kanë kryer akte të larta humanizmi heroizmi dhe sakrifice.

Duke iu referuar nenit 18 të Rregullores së sipërcituar, i propozoj Kuvendit të Komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim me të cilin z. Mubarem Shabani do të nderohet me titullin "Nderi i Qytetit".

Me respekt!



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: Kuvendi e Komunës

Propozues: Kryetari i Komunës

Hartues: Zyra e Kryetarit

Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 41 pika 41.2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës si dhe nenin 5 të Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënie e Dekoratave prot nr. 209/20 datë 29.10.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2022 merri këtë:

V E N D I M PËR NDARJE TË DEKORATËS "QYTETAR NDERI"

1. Me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, me titullin "Qytetar Nderi" i Vushtrrisë nderohen:

1.1 Z. Arif Vladi – artist/këngëtar i njohur shqiptar

1.2 Znj. Liri Rasha - artiste/këngëtare e njohur shqiptare

2. Dekoratat nga pika një e këtij vendimi i dorëzon Kryetari i Komunës në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melibate Basholli – Latifi
Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Sipas Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënie e Dekoratave prot nr. 209/20 datë 29.10.2020, citojmë: titulli "Qytetar nderi" është titulli më i lartë që i ipet personaliteteve të shquara politike, shoqërore, shkencore, letrare dhe artistike (vendor e ndërkombëtar) në shenjë respekti, miqësie apo mirënjohje për kontribute të veçanta në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve të Vushtrisë. Ky titull iu ipet gjithashtu personaliteteve të cilët në kohë të vështira ndihmuan dhe kontribuan për Lirinë e Kosovës.

Duke iu referuar nenit 18 të Rregullores së sipërcituar i propozoj Kuvendit të Komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim me të cilin z. Arif Vladi dhe Znj. Liri Rasha do t'i nderojmë me titullin më të lartë "Qytetar Nderi i Vushtrisë".

Me respekt!



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës *G. Pichumir*
Hartues: Zyra e Kryetarit *B. P. ...*
Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12. paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 41 pika 41.2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës si dhe nenin 7 të Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënie e Dekoratave prot. nr. 209/20 datë 29.10.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2022 merr këtë:

V E N D I M PËR NDARJE TË DEKORATËS "EMBLEMA E VUSHTRISË"

1. Me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, z. Bekim Shyti nga Vushtrria, ish Komandant i Njësisë Speciale të Zonës Operative të Shalës, i ipet çmimi "Emblema e Vushtrrisë".
2. Dekoratën nga pika një e këtij vendimi e dorëzon Kryetari i Komunës në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli - Latifi
Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Sipas Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënien e Dekoratave prot nr. 209/20 datë 29.10.2020, citojmë: çmimi “Emblema e Vushtrisë” i ipet personaliteteve të shquara të Komunës së Vushtrisë të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në rrafshin kombëtar, që janë personalitete të rëndësishme në fusha të veçanta, kanë një veprimtari të gjerë dhe të rëndësishme në interes të qytetarëve, si dhe tregojnë akte të larta të guximit dhe sakrificës.

Duke iu referuar nenit 18 të Rregullores së sipërcituar i propozoj Kuvendit të Komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim me të cilin z. Bekim Shyti do të nderohet me çmimin “Emblema e Vushtrisë”.

Me respekt!



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrisë

Për: Kuvendi e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës *G. Idunov*
Hartues: Zyra e Kryetarit *[Signature]*
Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 41 pika 41.2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës si dhe nenin 8 të Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënien e Dekoratave prot nr. 209/20 datë 29.10.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2022 merr këtë:

V E N D I M PËR NDARJE TË DEKORATËS "HASAN PRISHTINA"

1. Me rastin e shënimit të manifestimit "Ditët e Hasan Prishtinës", çmimi "Hasan Prishtina" iu ndahet:

- 1.1 Z. Ali Jonuzi, veteran i luftës së UÇK-së
- 1.2 Z. Idriz Asllani, veteran i luftës së UÇK-së
- 1.3 Z. Ramadan Manovi, veteran i luftës së UÇK-së

2. Dekoratat nga pika një e këtij vendimi i dorëzon Kryetari i Komunës në ditën e shënimit të kësaj date, më 10 qershor 2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Melihare Basholli – Latifi
Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Sipas Rregullores KKV nr. 08/20 për Dhënien e Dekoratave prot nr. 209/20 datë 29.10.2020, citojmë: çmimi “Hasan Prishtina” iu ndahet personaliteteve të shquara në shenjë respekti për kontributin e dhënë në fushën kombëtare, shkencore, kulturore, artistike dhe letrare. Ky çmim ndahet në manifestimet tradicionale “Ditët e Hasan Prishtinës”.

Duke iu referuar nenit 18 të Rregullores së sipërcituar i propozoj Kuvendit të Komunës që t’a miratoj këtë propozim vendim me të cilin z. Ali Jonuzi, z. Idriz Asllani dhe z. Ramadan Manovi do t’i nderojmë me këtë çmim në manifestimin “Ditët e Hasan Prishtinës” që do të mbahet me datën 10 qershor 2022.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATE/A:	06.05.2022
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Abit Abiti, ZKF 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport tremujor, Janar - Mars 2022

Në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L - 048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur raportin tremujor, i cili mbulon vitin fiskal e deri në fund të këtij tremujori që sapo ka përfunduar. Ky raport përmban shënime mbi arkëtimet, shpenzimet dhe një përmbledhje të shpenzimeve kapitale. Këtë raport e prezantojmë para KPF-Së dhe Kuvendit Komunal, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komunës.

Me respekt!

Shtojcë raportet:

Emri i Komunës :

K.K. VUSHTRRI

Kodi i Komunës:

604

Përmbledha raportuese

Janar - Mars

2022

TE HYBAT VETANAKE (THV) SIPAS DREKTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

Përkrahimi	Kodi	Përmbledha raportuese			Vjetore			Viti kaluar	
		Buxheti i planifikuar për PR	Të hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhetit të realizuar për PR	Buxheti i planifikuar për 2022	Buxheti i mbetur për 2022	Pranimi i reviduar		Dalimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar
		4	5	6 = 5/4*100	7	8 = 7-5	9	10 = 7-9	11
Administrata dhe personali	163	€	€	%	€	€	€	€	€
Taksa administrative		17,500.00	17,469.00	100%	70,000.00	52,531.00	0.00	70,000.00	13,495.00
TOTAL		17,500.00	17,469.00	100%	70,000.00	52,531.00	0.00	70,000.00	13,495.00
Inspeksioni	166	€	€	%	€	€	€	€	€
Pranimet teknike		1,250.00	1,245.00	100%	5,000.00	3,755.00	0.00	5,000.00	655.00
Pedigjimet sanitare		1,500.00		0%	6,000.00	6,000.00	0.00	6,000.00	1,691.79
Gjohat e inspeksionit		250.00	1,275.00	510%	1,000.00	-275.00	0.00	1,000.00	5,387.16
TOTAL		3,000.00	2,520.00	84%	12,000.00	9,480.00	0.00	12,000.00	8,243.95
Buxheti dhe financa	175	€	€	%	€	€	€	€	€
Taksat e firmave		2,500.00	14,250.00	570%	10,000.00	-4,250.00	0.00	10,000.00	6,000.00
Tatimi në pronë		264,917.25	200,854.34	76%	1,059,669.00	858,814.66	0.00	1,059,669.00	203,426.87
TOTAL		267,417.25	215,104.34	80%	1,069,669.00	854,564.66	0.00	1,069,669.00	209,426.87
Arsimi	900	€	€	%	€	€	€	€	€
Shtjta e prodimeve									
Participimi në çerçimin e rritjeve		11,250.00	11,643.00	103%	45,000.00	33,357.00	0.00	45,000.00	5,022.00
Shkollat e Mesme Teknike		3,750.00	4,620.00	123%	15,000.00	10,380.00	0.00	15,000.00	3,220.00
Shkollat e Mesme Profesionale		3,500.00	5,360.00	167%	14,000.00	8,140.00	0.00	14,000.00	6,946.00

TOTAL		18,500.00	22,123.00	220%	14,000.00	51,877.00	0.00	74,000.00	15,188.00
Gjeoedezia dhe Kadastro	650	€	€	%	€	€	€	€	€
Dirajia nga objektet publike		5,750.00	2,155.00	37%	23,000.00	20,845.00	0.00	23,000.00	2,155.00
Të hyrat nga Gjeoedezia dhe Kadastro		10,000.00	30,467.00	305%	40,000.00	9,533.00	0.00	40,000.00	25,135.12
TOTAL		15,750.00	32,622.00	207%	63,000.00	30,378.00	0.00	63,000.00	27,290.12
Kulturë, dini dhe sport	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Pastrira e sportit		250.00	48.00	19%	1,000.00	952.00	0.00	1,000.00	300.00
Biblioteka		125.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	46.00
Shërbija e Kulturës		250.00		0%	1,000.00	1,000.00	0.00	1,000.00	265.00
TOTAL		625.00	48.00	8%	2,500.00	2,452.00	0.00	2,500.00	611.00
Shërbime publike	880	€	€	%	€	€	€	€	€
Parkimet		500.00	880.00	176%	2,000.00	1,120.00	0.00	2,000.00	380.00
Regjistrimi i automjeteve		20,750.00	30,250.50	146%	83,000.00	52,749.50	0.00	83,000.00	27,920.00
Taksat e mbanurave		153,433.50	130,668.49	85%	613,734.00	483,065.51	0.00	613,734.00	118,592.65
TOTAL		174,683.50	161,798.99	93%	698,734.00	536,935.01	0.00	698,734.00	146,892.65
Bujësi	470	€	€	%	€	€	€	€	€
Adryshimi i destinimit të tokës		2,500.00	3,637.00	145%	10,000.00	6,368.00	0.00	10,000.00	14,341.69
Leje pure			50.00						
TOTAL		2,500.00	3,687.00	147%	10,000.00	6,368.00	0.00	10,000.00	14,341.69
Shëndetësi	700	€	€	%	€	€	€	€	€
Participim		12,500.00	11,227.50	90%	50,000.00	38,772.50	0.00	50,000.00	11,566.50
Participim Ops		500.00	830.00	166%	2,000.00	1,170.00	0.00	2,000.00	821.00
TOTAL		13,000.00	12,057.50	93%	52,000.00	39,942.50	0.00	52,000.00	12,387.50
Urbanizimi	660	€	€	%	€	€	€	€	€
Leje e ndërtimit		51,473.00	181,457.20	353%	205,892.00	24,434.80	0.00	205,892.00	94,922.22
Leje mjedësore			14,897.28						
Legalizimi i Objekteve			491.61						
Rrenim i objekteve									
Shërbime dhe pranës Publike		1,250.00	3,984.20	319%	5,000.00	1,015.80	0.00	5,000.00	10.00
TOTAL		52,723.00	200,890.29	381%	210,892.00	25,450.60	0.00	210,892.00	94,932.22
	850	€	€	%	€	€	€	€	€

Gjòbat e trafikut				0%				0.00	0.00	
Gjòbat e gjykatave				0%				0.00	0.00	
Gjòbat e pyetjeve		50.00		#VALUE!				0.00	0.00	7,035.73
Të thyrat tjera	0.00	21,023.00	#DIV/0!		0.00	-20,973.00		0.00	0.00	7,035.73
TOTAL										
	505,698.75	689,283.12	122%		2,262,795.00	1,573,511.88		0.00	2,262,795.00	509,804.73

PRILEZI
RISICI
Perioada raportare

KJC Vignettes
644

Janar - Mars

PERMBLENDHA E SHPENZIMJEREVE SIPAS BURIMIT TE FINANCIARIT

Raportimi i gjendjes te shpenzimit dhe zellimit per planin fqaror - Lunda Epitru

Përshkrimi	Kodi	PRILINDJA RAPORTUESE			VLETORJE			VITI Referor
		BUDZHETI FUNDORIKUJAVE	Sipërmasa e shpenzimit në % të shërbimit	Parafundia e shërbimit	Budhëti i planifikuar për 2022	Shërbimi i embleuar për 2022	Planit i realizuar për 2022	
	4	5	6 = 5/4*100 %	7	8 = 7-5	9	10 = 7-9	11
Procentiliga e shpenzimit	04	€	€	€	0.00	0.00	€	€
Gjendje - Censurë	10	2,884,456.82	2,824,666.12	17,652,275.34	34,724,207.24	0.00	17,461,174.24	3,067,724.43
Të mos vlerohet	21	649,246.74		3,342,796.00	3,742,796.00	0.00	2,362,795.00	77,744.96
Mirësi e burimeve	22				0.00	0.00	0.00	
Dedukime e korrigjime	31	42,091.39		52,091.25	52,091.25	0.00	52,091.25	
Dedukime e shërbimeve	32	48,677.34		47,899.38	21,274.00	0.00	42,099.38	
TOTALI		3,776,384.95	2,948,833.52	20,009,170.96	17,060,277.44	0.00	20,009,170.96	3,945,481.39

Per shkak te mos entralizimit te buxhetit sipas Nensës 20.3 të LLMPP, korrigjimi i shërbimit ju lejon shërbimit për shërbime 3/12 e buxhetit të vitit 2022

Kontrollimi	VJESHTORRI
Kodi	644
Periudha raportuese	Janar - Mars
	0.00

PËRMLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE

PËRSHKRITIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti i kaluar
		BUDZHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet e realizuar në PR	Përqindja e numërit të ditësuar	Budzheti planifikuar për 2022	Budzheti i realizuar për 2022	Plani i rëndësuar 2022	Oditimi në mes të budzhetit të planifikuar dhe planit të rëndësuar	
		4	5	5 = 5/4*100 %	7	8 = 7-5	9	10 = 7-9	11
		€	€		€	€	€	€	€
Paga dhe mëfije	111	2,821,088.88	2,477,888.20	87%	10,772,184.34	8,201,898.54	0.00	10,772,184.34	7,481,984.42
Manga dhe shërbime	130	668,193.26	560,342.18	83%	3,280,185.67	2,933,162.89	0.00	3,280,185.67	673,097.28
Shpenzimet komunale	132	68,968.76	82,387.84	93%	928,080.00	865,742.86	0.00	428,008.00	74,171.71
Sulvencionet dhe transferet	200	78,046.87	37,800.00	48%	672,240.00	634,340.00	0.00	672,240.00	40,798.04
Investimet kapitale	300	28,272.14	20,707.68	70%	4,851,640.95	4,834,933.95	0.00	4,851,640.95	166,472.14
Bejona					5,000.00	5,000.00		5,000.00	
TOTALU		3,776,568.58	2,945,893.52	78%	20,009,170.96	17,068,177.44	0.00	20,009,170.96	3,545,265.89

Në Kategorinë e investimeve kapitale kemi pasur vetëm një shpenzim nga donacionet e jashtme për projektin "Një vjeç në historik"

Emri i Komunitetit:	VUSHTRIA
Kodi i Komunitetit:	644
	Janar - Mars

Permbledhja e Shpenzimeve Sipas Drejtorive
PËRMBLEHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE

PËRSHIRJA	NOI	PERIUDHA RAPORTUESH		%	VITETOR				Viti i kaluar
		Buxheti i Shpenzimit të planifikuar për vitet e reeve të shokave të shokave	Realizuar në PR e reeve të shokave të shokave		Buxheti i Renditjes për vitet 2022	Bardhësi i mbetur për vitet 2022	Plan i reviduar 2022	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	
		€	€	%	€	€	€	€	€
Zyra e Kryetarit	160	64,238.27	64,238.27	69%	180,278.00	273,979.73	0.00	333,218.00	80,707.00
Rogatoritërat dhe përmbledhjet	163	184,804.23	93,104.23	56%	587,448.00	529,433.77	0.00	587,558.00	70,086.80
Indeksimi	166	18,740.42	10,586.61	99%	132,815.00	119,228.39	0.00	132,815.00	71,480.60
Prokurimi	167	6,184.82	6,181.95	100%	62,910.00	46,736.15	0.00	52,918.00	9,232.19
Zyra e shërbimit Komunal	168	31,825.29	31,825.29	100%	140,781.00	108,925.71	0.00	140,751.00	34,402.35
Buxheti dhe linjat	175	26,402.88	26,150.99	99%	200,678.00	164,525.03	0.00	200,676.00	32,347.83
Mbrojtja civile dhe energjia	180	583,881.44	180,197.62	31%	2,433,198.87	3,253,190.35	0.00	3,433,358.17	420,227.37
Zyra e Komunitetit Komunitetore	195	11,842.89	11,642.89	100%	77,871.00	66,728.11	0.00	77,871.00	10,302.04
Bujësi, Pyllçori, Zierjen e udrës	470	26,378.96	20,623.86	54%	168,853.00	737,769.04	0.00	758,653.00	17,642.95
Opodeti dhe shërbime	650	18,074.28	16,574.36	85%	97,497.00	80,922.63	0.00	97,497.00	10,138.81
Planifikimi urban dhe mjedisi	650	41,267.37	32,604.95	79%	1,252,785.71	1,219,849.05	0.00	1,252,785.71	87,887.88
Shërbimet primare	750	535,478.13	501,828.68	94%	2,828,106.36	2,376,260.71	0.00	2,628,106.34	580,940.75
Shërbimet sociale rezidencale		58,486.21	38,438.21	78%	299,611.00	261,122.79	0.00		40,149.21
Kulturë, Rekreacion, Sport	850	94,464.84	41,597.43	44%	688,383.46	657,785.88	0.00	699,383.46	49,035.71
Aktivitet	970	2,137,137.81	1,969,984.24	89%	8,128,469.28	7,219,465.04	0.00	9,128,459.28	2,450,893.85
TOTALI		3,776,364.56	2,948,893.52	78%	20,009,170.96	17,060,277.44	0.00	20,009,170.96	3,545,465.89

MREFI

Kodi i komunës:
Përludha raportuese

VJSHTRRI

544
Janar - Mars 2022

KODI	Mallrat dhe shërbimet	2021	2022
13130	Shpenzimet e udhëtimi zyrtar brenda vendit		
13132	Akomodimi i udhëtimi zyrtar brenda vendit	768.00	
13139	Shpenzimet e tjera të udhëtimi zyrtar brenda vendit		216.24
13140	Shpenzimet e udhëtimi zyrtar jasht vendit		
13141	Shpenzimet e vëgjele -para dhe pas		309.00
13142	Akomodimi i udhëtimi zyrtar jasht vendit		
13143	Shpenzimet tjera të udhëtimi zyrtar jasht vendit		39.00
13310	Shpenzimet për internet	799.90	1,948.25
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	1,784.39	1,589.42
13330	Shpenzimet postare	1,244.10	233.30
13410	Shpenzimet e arsimit dhe trajnimit		
13420	Shërbimet e përfaqsimi - avokati, etj	94.40	
13430	Shërbime të ngjyshme shëndetësore	1,472.30	150.00
13440	Shërbime të ngjyshme intelektuale dhe të shpirtërore	32.03	36.00
13450	Shërbime shtypëse - të marketingut		
13460	Shërbime kontraktuese tjera	268,947.00	242,260.28
13470	Shërbime letrare	93.90	400.00
13790	Shpenzimet për antarsim		
13490	Shërbimet e varimit	30,860.00	
13501	Mobile (më pak se 1000 euro)	6,193.90	493.00
13502	Kompiuter (më pak se 1000 euro)		
13504	Harduer për teknike informataive (më pak se 1000 euro)	332.38	
13506	Paçje makine (më pak se 1000 euro)		
13509	Paçje tjera (më pak se 1000 euro)		14,241.00
13506	Pajisje specialiste nekesore		
13508	Pajisje tjera (më pak se 1000 euro)	15,268.10	
13510	blenda e librave edhe veprave artistike		
13610	Furnizime për zyrë	15,345.90	9,271.68
13611	Furnizime me dokumenta blanke		
13620	Furnizime me ushqim dhe pajë tjera drejta zyrtare	2,331.46	2,270.82
13630	Furnizime mjekësore	5,762.15	2,090.50
13640	Furnizime pastrore	643.00	514.50
13650	Furnizime me veshmbathje	11,574.00	
13655	Furnizime me preparate kimike		991.00
13710	vaj		303.00
13720	Nafte për ngrohje qendrore	5,329.40	18,006.16
13730	Vaj për ngrohje qendrore		
13760	Oru	65,640.00	31,754.00
13770	Derivate për gjenerator	622.75	1,601.26
13780	Karburant për veturë	7,551.48	6,987.62
13790	Gas natyror		
13810	Avanc për para të imta	7,550.00	1,300.00
13820	Avanc për udhëtime zyrtare	900.00	3,139.00

13918	Provizion për tarla të ndryshme	1.038,50	
13950	Regjistrimi i automjeteve	430,00	2.101,85
13951	Sigurimi i automjeteve	960,00	
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	5.606,10	
14020	Mirëmbajtja e motorëve	456,04	161,00
14022	Mirëmbajtja e motorëve afariste		
14023	Mirëmbajtja e shkollave	2.623,90	1.289,00
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	750,00	
14032	Mirëmbajtja e automjeteve lokale	20.254,20	
14040	Mirëmbajtja e teknologjive informative	454,96	1.575,01
14050	Mirëmbajtja e mobilave dhe pasqevë	2.802,36	1.182,00
14090	Mirëmbajtja tuitore	25.632,80	
14110	Qaraja për ndërtesa		
14130	Qaraja - pajisjet	917,52	2.040,85
14140	Qaraja - makinaria	1.736,92	694,00
1415	Qaraja - përdorime tjera të hapësirave		
14210	Reklamat dhe turkuret		
14220	Balimet e publikimit		600,00
14230	Shpenzimet për informimin publik	999,00	799,60
14310	Drektat zyrtare	7.193,96	5.963,50
14410	Shpenzime-vendime të gjykatave	4.880,45	2.310,94
14415	Pagesat për rifit të vendimeve gjyqësore - përmbartmore		300,00
14510	Pagesa e lalmit në gjrë	918,00	
17000	Pagesa e borxhit qeveritar		
13	TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME	678.087,26	356.942,78

14			
13210	Rrymb	60.813,03	51.076,29
13220	Ujë	5.830,40	6.606,70
13230	Mbetunmat	5.963,81	4.040,90
13250	Shpenzimet telefonike	564,09	539,00
13260	Pagesa-vendime gjyqësore		
14	TOTALI I SHPENZIMEVE KOMUNALE	76.171,33	62.257,89

20	SUBVENCIONET		
2110	SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE		38.270,00
21120	SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE (TEATËR, BIBLIOTEK)		
21200	SUBVENCIONE PËR ENTITETET JOPUBLIKE	40.760,00	
20	TOTALI I SUBVENCIONEVE	40.760,00	38.270,00
	TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE	696.018,59	457.170,72



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

DATË:	05 maj 2022
PËR:	KPF-në dhe KK-në
PROPOZUES:	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës 
HARTUES:	Albanez Tahiraj Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë 
LËNDA:	PROPOZIM - VENDIM PARAPRAK për aprovimin e listës së veçantë që planifikohet për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 3 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 6 pika 1.1, nenit 8 pika 1.1 dhe nenit 13 paragrafi 1 dhe neni 14 paragrafi 1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 5, paragrafi 1.2, nenit 6, paragrafi 1 dhe nenit 8, të Rregullores (QRK) Nr.09/2022 Për Çaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe nenit 41 paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022 mori këtë :

VENDIM PARAPRAK
për aprovimin e listës së veçantë që planifikohet për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2022

1.Me këtë vendim aprovohet lista e veçantë që planifikohet për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m², P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m², P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m², ZK-Novolan, parcela P-70202053-00366-1 me sipërfaqe prej 25436m², ZK-Prelluzhë, parcela P-70202063-00037-0 me sipërfaqe prej 54774m², ZK-Strovc, parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m², parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m², parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m², ZK-Kollë, parcela P-70202040-

00431-0 me sipërfaqe prej 101525m², ZK-Dumnicë e Llugës, parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m², parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m², ZK-Stanoc i Poshtëm, parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m², ZK-Sllatinë, parcela P-70202062-0K106-1 me sipërfaqe prej 1002m², ZK-Qytezë, parcela P-70202010-00789-0 me sipërfaqe prej 28502m², ZK-Bukosh, parcela P-70202035-00474-0 me sipërfaqe prej 29693m², ZK-Liqen, parcela P-70202035-00482-0 me sipërfaqe prej 39838m², ZK-Liqen, parcela P-70202035-00483-0 me sipërfaqe prej 13638m², ZK-Liqen, pjesë nga parcela kadastrale P-70202011-00435-27, në sipërfaqe prej 2000m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 69457m², ZK Lummadh, ish-objekti i shkollës fillore në fshatin Stanoc i Epërm.

- 1.1 Parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m², P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m², P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m², ZK Novolan, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.2 Parcela P-70202053-00366-1 me sipërfaqe prej 25436m², ZK-Prelluzhë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.3 Parcela P-70202063-00037-0 me sipërfaqe prej 54774m², ZK-Strovc, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.4 Parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m², parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m², parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m², ZK-Kollë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.5 Parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m², ZK-Dumnicë e Llugës, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.6 Parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m², ZK-Stanoc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.7 Parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m², ZK-Stanoc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.8 Parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m², ZK-Sllatinë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.9 Parcela P-70202062-0K106-1 me sipërfaqe prej 1002m², ZK-Qytezë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.

1.10 Parcela P-70202010-00789-0 me sipërfaqe prej 28502m², ZK-Bukosh, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

